Udhëzues për Forcimin e Bashkëpunimit të Këshillave Vendorë Rinorë dhe Nismave të Përbashkëta me Aktorët Rinorë

Tabela e Përmbajtjes

1. Pse ky Udhëzues? *4*

2. Kuadri Ligjor dhe Institucional për Pjesëmarrjen Vendore të të Rinjve: nga Niveli Evropian në atë Kombëtar *5*

2.1. Lidhja e Veprimit Rinor Vendor me Zhvillimet Evropiane **5**

2.1.1 Strategjia e BE-së për Rininë 5

2.1.2 Parimet e Këshillit të Evropës 6

2.1.3 Harmonizimi me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029 7

2.2 Kuadri Kombëtar Ligjor dhe Institucional **7**

2.2.1 Këshillat Vendorë Rinorë (KVR): Roli dhe Mandati 7

2.2.2 Mekanizmat e Bashkëpunimit në Nivel Bashkiak 8

3. Parimet Themelore për Bashkëpunim Efektiv *9*

4. Hartëzimi i Ekosistemit Rinor Vendor: Aktorët Kryesorë Rinorë *11*

5. Modelet dhe Metodat për Angazhimin Bashkëpunues të të Rinjve dhe Nismat e Përbashkëta *14*

5.1 Modele dhe Mekanizma Bashkëpunimi **14**

6. Udhëzues Hap pas Hapi për Planifikimin e Nismave të Përbashkëta *22*

7. Komunikimi dhe Dukshmëria *25*

8. Menaxhimi i Rreziqeve dhe Zgjidhja e Konflikteve *28*

8.1. Zbutja e Rreziqeve gjatë Zbatimit të Projektit **28**

8.2. Zgjidhja e Konflikteve **30**

9. Monitorimi, Vlerësimi dhe Qëndrueshmëria *31*

9.1. Monitorimi **31**

9.2. Vlerësimi **32**

9.3. Qëndrueshmëria **33**

9.4. Treguesit e Cilësisë së Bashkëpunimit **34**

Referenca *35*

ANEKSET *37*

Aneksi 1 ..... **37**

Aneksi 2 ..... **38**

Aneksi 3 ..... **41**

Aneksi 4 ..... **44**

Aneksi 5 ..... **47**

Lista e Shkurtesave

AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
BE	Bashkimi Evropian
KKR	Këshilli Kombëtar Rinor
KVR	Këshilli Vendor Rinor
MCP	Menaxhimi i Ciklit të Projektit
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NEET	Të rinj jashtë punësimit, arsimit dhe formimit profesional
OPR	Organizata Përfaqësuese Rinore
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
ZRBR	Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor
SKR	Strategjia Kombëtare e Rinisë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
YËCA	Shoqata e Grave të Reja të Krishtera

1. Pse ky Udhëzues?

Këshillat Vendorë Rinorë (KVR) janë mekanizmi kryesor i strukturuar përmes të cilit të rinjtë mund të përfshihen në vendimmarrjen në nivel lokal në Shqipëri. Ato mund t'i ndihmojnë gjithashtu bashkitë ti qasen të rinjve nga prejardhje dhe grupe të ndryshme. Megjithatë, ndikimi i tyre në politikat vendore varet në masë të madhe nga mënyra se si bashkëpunojnë me ekosistemin më të gjerë rinor, përfshirë organizatat rinore, këshillat studentorë, qendrat rinore, grupet rinore joformale dhe autoritetet vendore.

Ky Udhëzues ofron hapa praktikë për forcimin e këtij bashkëpunimi dhe për t'i ndihmuar KVR-të të hartojnë dhe zbatojnë nisma të përbashkëta që janë gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe në përputhje me politikat kombëtare dhe evropiane për rininë. Ai orienton gjithashtu përdoruesit drejt platformave, metodave dhe burimeve ekzistuese për punën me dhe për të rinjtë.

Qëllimi i Udhëzuesit

Udhëzuesi synon t'i ndihmojë KVR-të të kalojnë nga ekzistenca formale drejt një bashkëpunimi kuptimplotë dhe praktik. Ai synon:

- t'u ofrojë KVR-ve një kuadër të qartë dhe praktik, parime, tregues dhe mjete për ta kthyer mandatin e tyre ligjor sipas Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë" në bashkëpunim, konsultim dhe bashkë-hartim efektiv me aktorët rinorë dhe autoritetet vendore;
- të mbështesë një qasje të qëndrueshme ndërmjet bashkive, në mënyrë që cilësia e bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes rinore të mos varet vetëm nga përkushtimi i një individi apo i kryetarit/es të bashkisë;
- të forcojë kapacitetet e KVR-ve për të përdorur përvojën dhe praktikat e mira evropiane dhe për të harmonizuar nismat vendore të bashkëpunimit me politikat dhe prioritetet kombëtare për rininë.

Përdoruesit e synuar

Udhëzuesi ofron informacion dhe mjete për KVR-të dhe aktorë të tjerë të ekosistemit rinor në Shqipëri, përfshirë:

- **Këshillat Vendorë Rinorë (KVR):** anëtarët e rinj të zgjedhur ose të emëruar dhe bashkëkryetarët, përfshirë kryetarët e bashkive, të cilët mund ta përdorin Udhëzuesin për të strukturuar takimet, nismat e përbashkëta dhe kontaktimin dhe angazhimin e popullatës më të gjerë rinore.
- **Aktorët rinorë:** organizatat rinore, këshillat studentorë, qendrat rinore dhe grupet rinore joformale, të cilat mund ta përdorin Udhëzuesin për t'u angazhuar me KVR-të dhe autoritetet vendore si partnerë, dhe jo vetëm si palë që konsultohen një herë.

- **Autoritetet vendore:** këshillat bashkiakë, zyrat e kryetarëve të bashkive dhe punonjësit përgjegjës për rininë, të cilët mund ta përdorin Udhëzuesin për të krijuar mekanizma institucionalë mbështetës, zëra buxhetorë, kohë pune të stafit dhe procedura vendimmarrëse që e bëjnë bashkëpunimin me të rinjtë të qëndrueshëm dhe jo rastësor.

Udhëzuesi mbështetet në politikat kombëtare dhe evropiane për rininë, si dhe në burimet e zhvilluara nga organizatat ndërkombëtare për punën rinore. Ai mbështet zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë (SKR) 2022–2029 dhe është në përputhje me kuadret kryesore evropiane, përfshirë Objektivat Evropiane për Rininë dhe parimet e Këshillit të Evropës, të cilat trajtohen në kapitujt vijues.

2. Kuadri Ligjor dhe Institucional për Pjesëmarrjen Vendore të të Rinjve: nga Niveli Evropian në atë Kombëtar

Ky kapitull shpjegon bazën ligjore dhe të politikave për KVR-të dhe arsyen e ekzistencës së tyre. Fillimisht trajton kuadrin evropian me rëndësi për Shqipërinë dhe më pas legjislacionin shqiptar për rininë dhe qeverisjen vendore. Ky kontekst i ndihmon KVR-të të kuptojnë kuadrin e politikave në të cilin veprojnë dhe si mund ta përdorin atë në praktikë.

2.1. Lidhja e Veprimit Rinor Vendor me Zhvillimet Evropiane

Politikat vendore për rininë në Shqipëri lidhen me tri pika kryesore reference: Strategjinë e BE-së për Rininë, punën afatgjatë të Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e të rinjve dhe Strategjinë Kombëtare të Rinisë, e cila i zbaton këto parime në kontekstin kombëtar. Së bashku, ato ofrojnë një bazë më të gjerë politikash për punën e KVR-ve në nivel vendor.

2.1.1 Strategjia e BE-së për Rininë

Strategjia e BE-së për Rininë 2019–2027 është një pikë e rëndësishme reference për politikat rinore në Evropë. Këshilli i Bashkimit Evropian e miratoi në nëntor 2018 për të forcuar rolin e të rinjve në jetën demokratike. Ajo synon të mbështesë pjesëmarrjen e plotë të të rinjve në shoqëri, angazhimin e tyre shoqëror dhe qytetar, si dhe qasjen në burimet dhe mundësitë që u duhen (Council of the European Union, 2018; European Youth Portal, 2024).

Strategjia mbështetet në tri ide kryesore: Engage, Connect and Empoëer – Angazhim, Lidhje dhe Fuqizim. Ajo përcakton njëmbëdhjetë Objektiva Evropiane për Rininë (European Commission, n.d.). Për këtë Udhëzues, mesazhi kryesor është se pjesëmarrja e të rinjve duhet të zhvillohet në çdo nivel, përfshirë nivelin vendor, me mbështetje kuptimplote për të rinjtë dhe organizatat rinore, që të ndikojnë në politikat që i prekin.

Strategjia Kombëtare e Rinisë (SKR) 2022–2029 e Shqipërisë mbështetet drejtpërdrejt në këto njëmbëdhjetë objektiva. Gjashtë prej tyre lidhen veçanërisht me punën e KVR-ve kur ato bashkëpunojnë në mënyrë efektive me aktorët rinorë:

- **Objektivi 2 – Barazi për të gjitha gjinitë:** asnjë i ri nuk duhet të përballet me diskriminim për shkak të gjinisë.
- **Objektivi 3 – Shoqëri gjithëpërfshirëse:** çdo i ri duhet të përfshihet, pavarësisht prejardhjes apo rrethanave të tij.
- **Objektivi 4 – Informacion cilësor, puna rinore dhe dialog konstruktiv:** KVR-të dhe partnerët e tyre komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të hapur, të qartë dhe të dyanshme.
- **Objektivi 6 – Përparimi i të rinjve në zonat rurale:** të rinjtë në zonat rurale duhet të kenë mundësi të barabarta.
- **Objektivi 9 – Hapësirë dhe pjesëmarrje për të gjithë:** të rinjtë duhet të kenë hapësira të sigurta dhe mundësi reale për të marrë pjesë në vendimmarrjen vendore.
- **Objektivi 11 – Organizatat rinore dhe programet evropiane:** çdo i ri duhet të ketë qasje në organizatat rinore dhe programet evropiane, duke kontribuar në një shoqëri të bazuar në vlera të përbashkëta evropiane.
- **Objektivat e tjerë:** pesë objektivat e mbetur – arritja dhe përfshirja e të rinjve (1), shëndeti mendor (5), punësimi (7), të nxënit (8) dhe mjedisi i qëndrueshëm (10) – mbeten po aq të rëndësishëm. Ato mund të përcaktojnë përmbajtjen e një nisme të përbashkët, për shembull një projekt që lidhet me punësimin ose mjedisin, edhe kur nuk janë fokusi i drejtpërdrejtë i metodave të bashkëpunimit të trajtuara në këtë Udhëzues.

Prandaj, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet një KVR-je dhe aktorëve rinorë është më shumë se një përmirësim në nivel vendor. Ai kontribuon në përmbushjen e angazhimeve kombëtare të Shqipërisë për rininë dhe, përmes tyre, në vizionin e përbashkët të Strategjisë së BE-së për Rininë.

2.1.2 Parimet e Këshillit të Evropës

Parimet, puna në fushën e politikave dhe kërkimi i zhvilluar nga Këshilli i Evropës për pjesëmarrjen e të rinjve përbëjnë një tjetër kuadër të rëndësishëm evropian dhe kanë ndihmuar në hartimin e këtij Udhëzuesi.

Bashkëmenaxhimi (co-management), është një nga metodat më të rëndësishme, gjerësisht të promovuara nga Këshilli i Evropës, për sa i përket pjesëmarrjes rinore. Të rinjtë nuk pyeten thjesht për mendimin e tyre pasi një vendim është marrë por ata marrin pjesë në vetë vendimmarrjen si partnerë të barabartë. Ata kontribuojnë në përcaktimin e përparësive, hartimin e nismave dhe shqyrtimin e rezultateve nga fillimi deri në fund. Në nivel vendor, kjo nënkupton krijimin e strukturave ku KVR-të dhe autoritetet bashkiake punojnë së bashku në kushte të barabarta, dhe jo strukturave ku bashkia konsultohet me të rinjtë dhe më pas vendos e vetme.

Ky parim mori mbështetje të re edhe më 12 mars 2026, kur Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi një Rekomandim drejtuar shteteve anëtare për Kartën Evropiane të Pjesëmarrjes së të Rinjve në Jetën Vendore dhe Rajonale (Council of Europe, 2026), i cili përditëson Kartën e Rishikuar të vitit 2003 (Council of Europe, 2003). Karta u kërkon autoriteteve vendore dhe

rajonale të krijojnë një mjedis të favorshëm, ku të rinjtë mund të marrin pjesë në mënyrë kuptimplote në vendimet që i prekin. Parimet e saj pasqyrohen në të gjithë këtë Udhëzues.

2.1.3 Harmonizimi me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029

Në Shqipëri, Strategjia Kombëtare e Rinisë (SKR) 2022–2029 është dokumenti kryesor i politikave që mbështet zbatimin e Ligjit "Për Rininë". Vizioni i saj është që të rejat dhe të rinjtë të bëhen partnerë aktivë në ndërtimin e së ardhmes së Shqipërisë. Strategjia përcakton objektiva konkrete për të zvogëluar boshllëqet në pjesëmarrje dhe për të forcuar angazhimin e të rinjve në komunitetet e tyre.

Ky Udhëzues mbështet drejtpërdrejt objektivin për t'u mundësuar të rinjve të marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe të shprehin zërin e tyre përmes politikave ndërsektoriale të koordinuara, të bazuara në evidencë dhe të mbështetura me burimet e nevojshme. Në praktikë, ai ndihmon KVR-të të bashkëpunojnë me aktorët rinorë dhe mbështet përhapjen ndërmjet bashkive të praktikave vendore që kanë rezultuar efektive, siç është pjesëmarrja e të rinjve në proceset e buxhetimit.

Të marra së bashku, nënseksionet 2.1.1–2.1.3 tregojnë se ky Udhëzues mbështetet si në politikat evropiane, ashtu edhe në ato kombëtare. Prandaj, forcimi i bashkëpunimit të KVR-ve me aktorët rinorë është pjesë e angazhimeve të vetë Shqipërisë në fushën e politikave rinore dhe jo thjesht një praktikë e marrë nga vende të tjera.

2.2 Kuadri Kombëtar Ligjor dhe Institucional

Pasi shqyrtuam kontekstin evropian dhe kombëtar të politikave, ky seksion kalon te legjislacioni shqiptar dhe ajo që ai përcakton për mandatin dhe funksionimin e KVR-ve.

Kushtetuta e Shqipërisë nuk e trajton "rininë" si kategori ligjore më vete. Neni 54 mbron së bashku fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja, si pjesë e detyrimit më të gjerë të shtetit për të mbrojtur grupet në nevojë. Baza kryesore ligjore për politikat rinore vjen nga një ligj i posaçëm.

Ligji nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar me Ligjin nr. 24/2025, përcakton si "të rinj" personat nga 15 deri në 29 vjeç (neni 3). Ai krijon gjithashtu institucionet, financimin dhe konceptet kryesore mbi të cilat mbështeten politikat rinore në nivel kombëtar dhe vendor. Këto koncepte shpjegohen më tej në Kapitullin 4.

Disa ligje sektoriale plotësojnë gjithashtu Ligjin "Për Rininë". Për shkak të qëllimit të këtij Udhëzuesi, ato nuk trajtohen këtu në detaje.

2.2.1 Këshillat Vendorë Rinorë (KVR): Roli dhe Mandati

Në nivel bashkiak, KVR-ja është organi kryesor që këshillon qeverisjen vendore për politikat rinore dhe shërben si homologu vendor i Këshillit Kombëtar Rinor. Neni 10 i Ligjit "Për Rininë", i ndryshuar me Ligjin nr. 24/2025, i jep pesë funksione kryesore: këshillon bashkinë për politikat

dhe planet rinore; monitoron zbatimin e tyre; propozon nisma vendore për të rinjtë; mban kontakte të rregullta me Këshillin Kombëtar Rinor; dhe, pas ndryshimit të vitit 2025, jep mendim për politika dhe çështje të tjera vendore që prekin të rinjtë, kur e kërkon bashkia. Ky funksion i fundit e lejon KVR-në të kontribuojë edhe përtej politikave që lidhen vetëm me rininë, kur bashkia kërkon mendimin e saj. KVR-ja është organ këshillimor i bashkisë. Ajo nuk ka personalitet juridik të vetin dhe këshillat e propozimet e saj nuk e detyrojnë bashkinë: ato hyjnë në fuqi vetëm kur i miraton bashkia dhe, kur kërkohet, këshilli bashkiak. Kjo ka rëndësi sa herë që KVR-ja nënshkruan marrëveshje ose punon sipas një modeli bashkëmenaxhimi (shih Kapitullin 5).

Ligji nr. 24/2025 jo vetëm zgjeroi çështjet për të cilat KVR-ja mund të japë mendim, por ndryshoi edhe mënyrën se si KVR-të organizohen dhe drejtohen. Katër ndryshime janë veçanërisht të rëndësishme:

- **Madhësia lidhet me bashkinë:** numri i anëtarëve të KVR-së është i barabartë me një të tretën e anëtarëve të këshillit bashkiak, kështu që bashkitë më të mëdha kanë KVR më të mëdha (neni 10, pika 2).
- **Përfaqësim më i lartë i të rinjve:** të paktën dy të tretat e anëtarëve të KVR-së duhet të jenë të rinj, ndërsa më parë kërkohej gjysma (neni 10, pika 2).
- **Bashkëkryesimi:** kryetari i bashkisë nuk e drejton më i vetëm KVR-në. Një anëtar i ri shërben gjithashtu si bashkëkryetar, duke i dhënë të rinjve një rol drejtues zyrtar/modeli i bashkëmenaxhimit (neni 10, pika 2).
- **Financimi:** ligji përcakton dy burime financimi për veprimtaritë e KVR-së – bashkinë dhe Agjencinë Kombëtare të Rinisë – duke i dhënë KVR-së një bazë ligjore më të qartë për të siguruar burime (neni 10, pika 2/1).

Së bashku, këto ndryshime forcojnë madhësinë, udhëheqjen rinore dhe bazën e burimeve të KVR-ve. Referencat për nenet i përkasin Ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i ndryshuar me Ligjin nr. 24/2025.

2.2.2 Mekanizmat e Bashkëpunimit në Nivel Bashkiak

Përveç vetë KVR-së, ka disa mekanizma lidhin bashkitë me sektorin rinor. Shumë prej tyre janë ende relativisht të rinj dhe vazhdojnë të zhvillohen në praktikë:

- **Vendimet e këshillit bashkiak:** planet vendore për rininë dhe rregullat e funksionimit të KVR-së bëhen të detyrueshme vetëm pasi miratohen zyrtarisht nga këshilli bashkiak (Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore").
- **Strategjitë dhe planet vendore të veprimit për rininë:** ligji i detyron bashkitë të krijojnë KVR-të dhe planet vendore, ndërsa strategjitë e posaçme vendore për rininë shpesh zhvillohen me mbështetjen e donatorëve dhe të organizatave të shoqërisë civile dhe jo si rezultat i një detyrimi ligjor të posaçëm.

- **Buxhetimi me pjesëmarrje:** bashkitë janë të detyruara të zhvillojnë procese buxhetimi me pjesëmarrje. Të rinjtë mund t'i përdorin ato, si çdo qytetar tjetër, për të ndikuar në shpenzimet vendore, megjithëse pjesëmarrja e tyre mbetet e kufizuar në praktikë (Lula, 2023).
- **Platformat e konsultimit vendor:** platforma kombëtare "Konsultimi Vendor" (konsultimivendor.al) u lejon qytetarëve, përfshirë të rinjtë, të paraqesin mendime për çështje vendore (Lula, 2023).
- **Pikat e kontaktit për rininë dhe koordinimi bashkiak:** bashkitë pritet të caktojnë një punonjës që koordinon punën për rininë, megjithëse kjo përgjegjësi shpesh kombinohet me detyra të tjera (Ministry of State for Youth and Children, 2022).
- **Koordinimi KVR–KKR:** KVR-të kanë detyrimin ligjor të mbajnë kontakte me Këshillin Kombëtar Rinor, duke krijuar një lidhje midis pjesëmarrjes së të rinjve në nivel vendor dhe atij kombëtar.

Këta mekanizma nuk e zëvendësojnë rolin e KVR-së. Përkundrazi, ata u ofrojnë KVR-ve disa pika hyrëse në vendimmarrjen dhe politikëbërjen në nivel vendor.

Lista e Kontrollit

☐ Dimë që KVR-ja është organ këshillimor i bashkisë dhe se vendimet përfundimtare i merr këshilli bashkiak.

☐ KVR-ja përmbush rregullat e nenit 10: madhësia lidhet me këshillin bashkiak, të paktën dy të tretat e anëtarëve janë të rinj dhe KVR-ja bashkëkryesohet nga kryetari i bashkisë dhe një anëtar i ri.

☐ Këshilli bashkiak ka miratuar rregullat për përzgjedhjen e anëtarëve të KVR-së dhe për kompensimin e shpenzimeve të tyre.

☐ KVR-ja ka një burim financimi në buxhetin e bashkisë dhe ka pyetur Agjencinë Kombëtare të Rinisë për mbështetje.

☐ Dimë kush është pika e kontaktit e bashkisë për rininë dhe si mund ta kontaktojmë.

3. Parimet Themelore për Bashkëpunim Efektiv

Bashkëpunimi efektiv ndjek një sërë parimesh të nxjerra nga kërkimi dhe praktika e mirë (European Economic and Social Committee, YPN, 2024; DYPALL Netëork, 2023), pavarësisht nëse procesi niset nga një KVR, një organizatë rinore apo bashkia. Çdo parim duhet të pasqyrohet në çdo nismë të përbashkët ku përfshihet një KVR.

Pjesëmarrje kuptimplotë: të rinjtë duhet të kenë një mundësi të vërtetë për të ndikuar në vendime, dhe jo thjesht të informohen ose të konsultohen pasi vendimet janë marrë. Një takim ku KVR-ja informohet për një plan të përfunduar nuk është pjesëmarrje kuptimplote. Të rinjtë duhet të trajtohen si partnerë në demokracinë vendore dhe njohuritë e tyre duhet të vlerësohen po aq sa ato të zyrtarëve e ekspertëve. Kjo pasqyron modelin e bashkëmenaxhimit të Këshillit të Evropës. Shkalla e Pjesëmarrjes e Hart-it (Hart, 1992) ofron një test të dobishëm gjithashtu. Ajo e ndan

manipulimin, dekorimin dhe pjesëmarrjen simbolike nga pjesëmarrja e vërtetë, dhe shkallët më të larta, ku të rinjtë nisin projekte ose ndajnë vendimet me të rriturit, janë standardi që synon ky Udhëzues.

Përfshirje dhe përfaqësim: një KVR duhet të pasqyrojë larminë e popullatës rinore të bashkisë dhe jo vetëm anëtarët më aktivë. Kjo kërkon kontakt aktiv me të rinjtë që është më e vështirë t'i arrish, përfshirë ata në zonat rurale, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe ata që janë më pak të organizuar ose më pak të sigurt për të marrë pjesë. Përfaqësimi nuk ka të bëjë vetëm me kë ka në dhomë, por me faktin nëse dhoma pasqyron komunitetin më të gjerë. Këshillat vendorë rinorë gjithëpërfshirës janë gjithashtu një shqetësim qendror i cilësisë për DYPALL Netëork (2023).

Pronësi dhe përgjegjësi e përbashkët: bashkëpunimi funksionon më mirë kur të gjithë të përfshirët – të rinjtë, KVR-ja, bashkia dhe partnerët e tjerë – e dinë qartë për çfarë janë përgjegjës. Rolet e qarta dhe të përbashkëta zvogëlojnë boshllëqet dhe ndihmojnë që partneritetet të vazhdojnë përtej individëve ose aktiviteteve të veçanta.

Transparencë dhe llogaridhënie: të rinjtë dhe aktorët e tjerë duhet të dinë se si merren vendimet, dhe jo vetëm çfarë është vendosur. KVR-ja dhe partnerët e saj duhet të jenë të hapur për rolet e tyre, për rezultatet dhe për mënyrën se si kontributi i të rinjve ka ndikuar në vendime. Nëse një propozim nga një konsultim nuk përdoret, duhet shpjeguar arsyeja. Një përgjigje e qartë ndihmon në ruajtjen e besimit.

Bashkëpunim i udhëhequr nga të rinjtë dhe ndërmjet shumë aktorëve: të rinjtë duhet të ndihmojnë në përcaktimin e përparësive dhe në formësimin e nismave që ndikojnë në jetën e tyre. Kjo e bën një nismë të udhëhequr nga të rinjtë dhe jo thjesht një nismë ku të rinjtë janë konsultuar. Në të njëjtën kohë, KVR-të nuk mund të punojnë vetëm. Bashkitë, organizatat rinore dhe institucionet e tjera ofrojnë ekspertizë, burime dhe mbështetje që ndihmojnë t'i kthejnë idetë e të rinjve në veprim.

Vazhdimësi dhe qëndrueshmëri: bashkëpunimi nuk duhet të varet nga një anëtar i vetëm i angazhuar i KVR-së. Strukturat e qëndrueshme, proceset e dakordësuara, dokumentimi dhe burimet financiare (dhe jo vetëm) ndihmojnë që nismat të vazhdojnë edhe kur ndryshojnë anëtarët ose stafi. Kështu një aktivitet i vetëm kthehet në praktikë të qëndrueshme.

Veprim i bazuar në evidencë dhe që u përgjigjet nevojave: nismat duhet t'u përgjigjen nevojave të të rinjve në komunitet, duke u mbështetur në evidencë, konsultim, reagime dhe të dhëna vendore. Ajo që funksionon në një bashki mund të mos funksionojë në një tjetër.

Bashkëpunim i mbështetur me burime: nismat e përbashkëta kanë nevojë për një buxhet të dakordësuar, kohë pune të stafit ose burime në natyrë përpara se të fillojnë. Nismat që mbështeten vetëm te vullneti i mirë kanë më shumë gjasa të ngecin gjatë zbatimit.

Siguria dhe Mbrojtja e të dhënave: Ligji "Për Rininë" i përcakton të rinjtë si persona nga 15 deri në 29 vjeç, prandaj disa anëtarë të KVR-së dhe disa pjesëmarrës në nismat e përbashkëta janë të mitur (nën 18 vjeç). Çdo nismë e përbashkët duhet t'i mbrojë ata dhe të respektojë privatësinë e të

gjithëve. Kjo do të thotë: të merret pëlqimi i prindërve ose i kujdestarëve për të miturit, kur kërkohet; të dhënat personale të mblidhen dhe të ruhen vetëm sa është e nevojshme dhe sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave; të kërkohet pëlqimi përpara se të fotografohen, filmohen ose të publikohen imazhe apo histori të të rinjve, përfshirë në rrjetet sociale; dhe aktivitetet të planifikohen që të jenë të sigurta, të aksesueshme dhe të respektueshme, me një person të caktuar që merret me shqetësimet për mbrojtjen. Partnerët duhet t'i dakordësojnë këto rregulla që në fillim dhe t'i pasqyrojnë në Marrëveshje të Bashkëpunimit (Aneksi 4).

Këto nëntë parime ofrojnë një standard për vlerësimin e çdo modeli bashkëpunimi në këtë Udhëzues. Një metodë që duket efikase, por e shpërfill transparencën ose përfshirjen, nuk është efektive, ajo vetëm e zhvendos problemin diku tjetër.

Lista e Kontrollit

☐ Të rinjtë kanë ndihmuar në formësimin e idesë dhe të vendimeve, dhe jo vetëm kanë marrë pjesë.

☐ Pjesëmarrësit pasqyrojnë larminë e të rinjve në nivel vendor, kemi arritur përtej anëtarëve tanë të zakonshëm.

☐ Rolet, vendimet dhe rezultatet janë dokumentuar dhe ndarë me partnerët dhe pjesëmarrësit.

☐ Buxheti, koha e stafit ose mbështetja në natyrë janë dakordësuar përpara se të fillonim.

☐ Janë marrë masa për pëlqimin dhe mbrojtjen e të rinjve, përfshirë të miturit.

☐ Mbahen shënime, që puna të vazhdojë kur ndryshojnë anëtarët ose stafi.

4. Hartëzimi i Ekosistemit Rinor Vendor: Aktorët Kryesorë Rinorë

Ky kapitull hartëzon ekosistemin rinor me të cilin një KVR mund të punojë në Shqipëri. Fillimisht paraqet grupet e aktorëve të përcaktuara në Ligjin "Për Rininë", të ndjekura nga aktorë të tjerë që nuk përmenden në mënyrë të posaçme në ligj, por që kanë rëndësi në praktikë. Së bashku, ato i ndihmojnë KVR-të të identifikojnë partnerë dhe të përfshijnë aktor të ndryshëm.

<u>Aktorët e përcaktuar me ligj</u>

- **Organizatat rinore:** organizata jofitimprurëse të regjistruara, qëllimi kryesor i të cilave është të përfaqësojnë dhe të promovojnë interesat e të rinjve. Të paktën 70% e anëtarëve të tyre (ose dy të tretat e bordit, për organizatat që drejtohen nga bordi) duhet të jenë vetë të rinj. Ligji "Për Rininë" i konsideron ato aktorë kyç në politikat rinore.
- **Organizatat për të rinjtë:** subjekte jofitimprurëse, fusha kryesore e veprimtarisë së të cilave nuk është rinia, por që punojnë gjithashtu për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të të rinjve dhe kanë përvojë të dokumentuar në zbatimin e programeve për të rinjtë.

- **Këshilli Kombëtar Rinor (KKR):** organi këshillimor me 18 anëtarë pranë ministrisë përgjegjëse për rininë, i bashkëkryesuar nga ministri dhe një prej anëtarëve të tij të rinj. Të paktën dy të tretat e anëtarëve të tij janë të rinj dhe ai synon të përfaqësojë grupet e margjinalizuara, të rinjtë me nevoja të veçanta, të rinjtë e diasporës dhe të dyja gjinitë. Për një KVR, KKR-ja krijon një lidhje ndërmjet përparësive rinore vendore dhe diskutimeve të politikave në nivel kombëtar.
- **Organizata Përfaqësuese Rinore (OPR):** një organ përfaqësues, i njohur sipas Ligjit "Për Rininë", që bashkon organizatat rinore dhe mund t'i përfaqësojë ato në nivel kombëtar. Ligji përcakton kërkesa të posaçme për mënyrën se si ajo formohet dhe njihet.
- **Qendrat rinore:** hapësira fizike ku të rinjtë takohen, mësojnë dhe organizojnë aktivitete. Ligji i ndryshuar "Për Rininë" përcakton rolin e tyre në ofrimin e infrastrukturës, informacionit, mentorimit, trajnimit dhe edukimit joformal. Një qendër rinore mund të jetë publike (e drejtuar nga bashkia), e përbashkët (bashkia së bashku me një ose më shumë organizata rinore, në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi), ose jopublike (e drejtuar privatisht).
- **Grupet rinore joformale:** grupe të rinjsh që ndajnë një qëllim të përbashkët, por nuk janë të regjistruar si organizatë formale, shpesh të krijuara rreth një çështjeje, interesi ose fushate vendore. Ndryshimet e vitit 2025 në Ligjin "Për Rininë" i njohën zyrtarisht këto grupe dhe rolin e tyre në komunitet.
- **Punonjësit rinorë:** persona që punojnë drejtpërdrejt me të rinjtë për të mbështetur zhvillimin e tyre personal dhe shoqëror, qoftë të paguar ose vullnetarë dhe qoftë të angazhuar në një institucion publik, organizatë rinore ose qendër rinore.

<u>Aktorë të tjerë që duhen përfshirë në hartëzim</u>

- **Këshillat studentorë:** organe të zgjedhura studentore në nivel universitar. Universitetet përcaktojnë rregullat e tyre për këto struktura sipas Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë", dhe ato i japin një KVR-je qasje në këndvështrimet e studentëve për arsimin, punësimin, aftësitë dhe shërbimet vendore.
- **Këshillat e nxënësve:** struktura përfaqësuese të nxënësve në nivel shkolle. Ato ekzistojnë në praktikë, megjithëse Ligji nr. 69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar" nuk i rregullon drejtpërdrejt. Ato përbëjnë një nga kanalet e pakta të drejtpërdrejta për të arritur nxënësit e arsimit të mesëm për konsultime, fushata dhe nisma të përbashkëta.
- **Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë:** një platformë kombëtare për përfaqësimin e nxënësve, e cila mund të lidhë pjesëmarrjen në nivel vendor të shkollës me diskutime më të gjera në nivel kombëtar.
- **Rrjetet rinore:** rrjete rajonale, kombëtare ose tematike që lidhin organizata dhe të rinj rreth një interesi të përbashkët. Ato ndihmojnë në shkëmbimin e informacionit, mobilizimin dhe bashkëpunimin përtej një bashkie të vetme.

- **Shkollat Qendër Komunitare:** shkolla që lidhen me familjet dhe komunitetin më të gjerë dhe ofrojnë hapësira të dobishme për aktivitete rinore dhe kontaktim e angazhim. Ato mund ta ndihmojnë një KVR të arrijë nxënësit, prindërit, mësuesit dhe aktorë të tjerë të komunitetit.
- **Bibliotekat dhe hapësirat kulturore:** bibliotekat publike, qendrat kulturore dhe muzetë mund të ofrojnë hapësira të aksesueshme për informacion, të nxënë dhe aktivitete të udhëhequra nga të rinjtë.
- **Zyrat e punësimit:** strukturat rajonale dhe vendore të punësimit, të drejtuara nga AKPA, që janë të rëndësishme kur një KVR punon për punësimin e të rinjve, të rinjtë NEET, orientimin në karrierë ose kalimin nga arsimi në punë.
- **Strukturat rinore të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare:** këshilla rinorë, borde këshillimore dhe rrjete ambasadorësh të lidhura me ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare. Ato mund të ofrojnë mundësi për shkëmbim, trajnim dhe bashkëpunim në projekte dhe ia vlen të përfshihen në hartëzim si partnerë të mundshëm, megjithëse nuk janë struktura të krijuara nga legjislacioni shqiptar.
- **Organizata dhe grupe rinore rome dhe egjiptiane:** organizata dhe grupe të udhëhequra nga të rinj romë e egjiptianë ose që punojnë me ta, të cilët mund të hasin pengesa të veçanta për të marrë pjesë në jetën vendore. Hartëzimi i tyre në mënyrë të qartë e ndihmon KVR-në të arrijë të rinj që përndryshe mund t'i lërë jashtë.
- **Organizata të personave me aftësi të kufizuara:** organizata që përfaqësojnë të rinjtë me aftësi të kufizuara ose punojnë me ta. Ato mund të këshillojnë për aksesueshmërinë dhe të ndihmojnë në përfshirjen e këtyre të rinjve në nismat e përbashkëta.
- **Sektori privat:** bizneset, punëdhënësit dhe shoqatat e punëdhënësve mund të ofrojnë praktika, mentorim, sponsorizim ose mbështetje në natyrë, veçanërisht për nismat që lidhen me punësimin dhe aftësitë.
- **Aktorë të tjerë vendorë:** në varësi të nevojave vendore, hartëzimi mund të përfshijë edhe drejtoritë bashkiake, shërbimet sociale, institucionet shëndetësore, organizatat sportive e kulturore dhe mediat vendore – çdo aktor që ndikon në mundësitë e të rinjve.
- **Përfaqësuesi Rinor në Bordin Drejtues të** Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor, në Shqipëri, Përfaqësuesi Rinor i RYCO-s është një i ri që është anëtar i Bordit Drejtues të RYCO-s së bashku me ministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor përgjegjës për rininë. Përfaqësuesi ka një mandat trevjeçar dhe përzgjidhet përmes një procesi transparent ku përfshihet shoqëria civile rinore.

Një hartë e aktorëve është e dobishme vetëm nëse një KVR di si të punojë me aktorët që identifikon. Kapitulli vijues paraqet modele të ndryshme bashkëpunimi, nga marrëveshjet formale deri te mjetet e përbashkëta online.

Lista e Kontrollit

☐ Kemi listuar partnerët ekzistues, partnerët e mundshëm dhe zërat që mungojnë (Aneksi 2).

☐ Harta përfshin organizatat rome dhe egjiptiane, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, grupet joformale dhe sektorin privat, kur është e përshtatshme.

☐ Çdo aktor ka një person kontakti të emëruar në KVR.

☐ E rishikojmë hartën të paktën një herë në vit, për shembull pas rinovimit të anëtarësisë.

5. Modelet dhe Metodat për Angazhimin Bashkëpunues të të Rinjve dhe Nismat e Përbashkëta

Ky kapitull është një paketë praktike mjetesh dhe metodha që KVR mund të përdor. Ai paraqet gjashtë lloje bashkëpunimi që një KVR mund të përdorë me aktorët rinorë dhe shpjegon se si mund të funksionojë secili prej tyre në praktikë.

5.1 Modele dhe Mekanizma Bashkëpunimi

5.1.1 Mekanizma Formalë

Një mekanizëm formal është i dokumentuar, me anëtarësi të qartë dhe mandat të përcaktuar. Ai mund të vazhdojë edhe kur ndryshojnë personat e përfshirë, sepse nuk varet nga vullneti i mirë individual.

Memorandume Mirëkuptimi (MM)

Çfarë është

Një marrëveshje me shkrim ndërmjet KVR-së dhe një partneri, e cila përcakton se çfarë do të bëjë secila palë, për sa kohë dhe me çfarë burimesh. KVR-ja është organ këshillimor i bashkisë dhe nuk ka personalitet juridik të vetin, prandaj një Marrëveshja e Bashkëpunimit që përfshin KVR-në nënshkruhet nga bashkia (përmes kryetarit të bashkisë si bashkëkryetar i KVR-së) ose drejtoria përgjegjëse për rininë. Organizata partnere nënshkruan në emër të vet, ndërsa bashkëkryetari i ri dhe anëtarët e KVR-së mund të emërohen si persona kontakti përgjegjës.

Si mund të zbatohet

- dakordësoni objektivin dhe fushën e bashkëpunimit përpara hartimit;
- hartoni kushtet që mbulojnë rolet, burimet, kohëzgjatjen dhe një klauzolë për përfundimin e marrëveshjes;
- dakordësoni tekstin brenda KVR-së, pastaj nënshkruajeni nga bashkia (përmes kryetarit të bashkisë si bashkëkryetar) ose miratojeni me vendim të këshillit bashkiak, dhe nënshkruajeni nga organizata partnere; dhe
- rishikojeni në intervale të përcaktuara, në vend që ta lini pa afat.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

I jep partneritetit parashikueshmëri dhe krijon një dokumentacion që mbetet i vlefshëm edhe kur ndryshojnë stafi ose anëtarët e KVR-së.

Grupet e Përbashkëta të Punës

Çfarë është

Një ekip që bashkon anëtarë të KVR-së, përfaqësues të aktorëve rinorë dhe staf bashkiak për të hartuar ose mbikëqyrur një nismë të caktuar, qoftë për një periudhë të përcaktuar ose në mënyrë të vazhdueshme.

Si mund të zbatohet

- përcaktoni nismën dhe ekspertizën e nevojshme përpara krijimit të grupit;
- dakordësoni mandatin, shpeshtësinë e takimeve dhe përfundimin e punës së grupit (ose datën e rinovimit); dhe
- caktoni një lehtësues përgjegjës për ta mbajtur grupin të fokusuar në detyrën e tij.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Është një metodë formale fleksibël: një grup mund të krijohet për një projekt të vetëm dhe të shpërndahet pas përfundimit të tij, ose mund të vazhdojë të funksionojë për një çështje të përsëritur, siç është planifikimi i buxhetit.

Strukturat Institucionale të Pjesëmarrjes (Parlamente Rinore, Forume)

Çfarë është

Përveç vetë KVR-së, Karta e Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e të rinjve rekomandon struktura të përhershme si parlamente rinore ose forume. Ato mund të përfshijnë përfaqësues të zgjedhur ose të emëruar që pasqyrojnë larminë e komunitetit, marrin përgjegjësi për projekte dhe paraqesin propozime pranë autoriteteve vendore.

Si mund të zbatohet

- u jepni strukturës një mision të qartë dhe afatgjatë (për shembull, politikat për rininë në bashki), që ajo të jetë e përhershme dhe jo e krijuar për një ngjarje të vetme; për punë mbi një çështje të caktuar, përdorni një grup të përbashkët pune;
- sigurohuni që anëtarësia të pasqyrojë larminë e komunitetit dhe grupet e interesit, dhe jo vetëm organizatat rinore më aktive; dhe
- siguroni një hapësirë fizike të njohur dhe mbështetje për zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve rinore.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

I jep aktorëve rinorë një vend të qëndrueshëm ku përgatiten propozimet që i dërgohen bashkisë, si dhe një hapësirë për të zhvilluar, monitoruar dhe vlerësuar projekte rinore. Ajo plotëson KVR-në dhe nuk e zëvendëson atë.

Bashkëmenaxhimi

Çfarë është

Një metodë ku të rinjtë dhe përfaqësuesit e autoriteteve vendore marrin vendime së bashku si partnerë të barabartë, dhe jo ku autoritetet vendosin pasi kanë konsultuar të rinjtë. Është modeli që përdoret në qeverisjen e sektorit rinor të Këshillit të Evropës dhe ka ndikuar edhe në ndryshimet e vitit 2025 të Ligjit "Për Rininë", që ndryshuan mënyrën e drejtimit të KVR-ve. E njëjta qasje mund të zbatohet në hartimin dhe realizimin e nismave e projekteve të veçanta. Në Shqipëri kjo funksionon brenda kufijve të ligjit: KVR-ja mbetet organ këshillimor dhe vendimet përfundimtare për çështjet bashkiake i merr këshilli bashkiak. Prandaj bashkëmenaxhimi zbatohet më mirë në hartimin dhe realizimin e nismave të përbashkëta dhe në vendime që bashkia ka pranuar zyrtarisht t'i ndajë, si përzgjedhja e projekteve në një skemë grantesh për të rinjtë, dhe jo në vendime që ligji ia rezervon këshillit bashkiak.

Si mund të zbatohet

- përcaktoni cilat vendime (p.sh. përzgjedhja e projekteve në një zë të caktuar buxhetor ose program) do të merren së bashku, me zë të barabartë për secilën palë, brenda asaj që ka miratuar këshilli bashkiak;
- vendosni rregulla të qarta për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet palës rinore dhe palës së autoriteteve; dhe
- rishikoni periodikisht marrëveshjen për të konfirmuar se të dyja palët vazhdojnë ta konsiderojnë atë të barabartë në praktikë dhe jo vetëm në dokumente.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Është një provë e qartë e ndarjes së pushtetit: autoriteti vendimmarrës ushtrohet bashkërisht dhe jo nga njëra palë pasi ka konsultuar tjetrën.

5.1.2 Bashkëpunim Joformal

Bashkëpunimi joformal është fleksibël dhe jo detyrues dhe mbështetet në marrëdhënie dhe besim, jo në një marrëveshje me shkrim. Zakonisht krijohet shpejt dhe mund të jetë një mënyrë e aksesueshme për përfshirjen e grupeve të reja ose grupeve rinore joformale.

<u>Partneritete për Fushata</u>

Çfarë është

KVR-ja dhe një ose më shumë aktorë rinorë zhvillojnë së bashku një fushatë ndërgjegjësimi, kontaktimi dhe angazhimi ose advokimi.

Si mund të zbatohet

- identifikoni një temë të përbashkët që u shërben të dy partnerëve;
- dakordësoni në mënyrë joformale kontributet e secilit (kontaktim dhe angazhim, dizajn, buxhet);
- mbani një ndarje të qartë dhe të dakordësuar të përgjegjësive; dhe
- mbani më pas shënime të shkurtra të brendshme për të ruajtur kujtesën institucionale.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Ndërton shpejt dukshmëri dhe besim dhe mund të bëhet hapi i parë drejt një mekanizmi më formal.

Aktivitete të Bashkëorganizuara

Çfarë është

KVR-ja dhe një partner organizojnë së bashku një aktivitet të vetëm ose të përsëritur, si një forum rinor, ditë e hapur ose trajnim.

Si mund të zbatohet

- dakordësoni një datë dhe një objektiv të përbashkët;
- ndani detyrat organizative (ambienti, kontaktimi dhe angazhimi, lehtësimi); dhe
- dokumentoni pjesëmarrësit dhe çdo veprim vijues për të cilin është rënë dakord.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Është një mënyrë praktike që një KVR të arrijë të rinj përtej anëtarësisë së vet, veçanërisht në bashki më të vogla ose rurale.

Edukimi dhe Kontaktimi mes Bashkëmoshatarëve (Peer-to-Peer)

Çfarë është

Të rinjtë mësojnë ose informojnë të rinj të tjerë për çështje të tilla si shëndeti, të drejtat qytetare ose mundësitë vendore. Këshilli i Evropës i identifikon qasjet Peer-to-Peer si një formë të zakonshme të pjesëmarrjes së të rinjve në praktikë.

Si mund të zbatohet

- identifikoni anëtarë të KVR-së ose të rinj të angazhuar nga aktorët partnerë, të gatshëm të veprojnë si edukatorë Peer-to-Peer;
- pajisini ata me trajnim bazë ose pika kryesore për komunikim; dhe
- lidheni kontaktimin Peer-to-Peer me një nismë të caktuar të KVR-së, në vend që ta lini si aktivitet të shkëputur.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Zgjeron shtrirjen e KVR-së përmes marrëdhënieve të cilave të rinjtë tashmë u besojnë, dhe jo vetëm përmes kanaleve zyrtare.

5.1.3 Platforma Digjitale për Planifikim të Përbashkët dhe Dialog

Mjete dhe hapësira online që e mbajnë bashkëpunimin aktiv ndërmjet takimeve dhe krijojnë një dokumentim të përbashkët, të cilit partnerët mund t'i rikthehen.

Mjete të Përbashkëta për Planifikim

Çfarë është

Dokumente, tabela pune ose kalendarë online, të aksesueshëm nga KVR-ja dhe partnerët e saj, për hartimin e përbashkët të agjendave dhe ndjekjen e nismave të përbashkëta ndërmjet takimeve.

Si mund të zbatohet

- zgjidhni mjete të aksesueshme dhe me kosto të ulët që partnerët mund t'i përdorin realisht; dh
- integrojeni mjetin në ciklin ekzistues të takimeve, në vend që ta përdorni si një kanal paralel.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Zvogëlon varësinë nga kryetari ose sekretariati i KVR-së si pika e vetme e koordinimit.

Platforma për Dialog dhe Konsultim

Çfarë është

Hapësira online, si portale, formularë ose kanale grupi, përmes të cilave aktorët rinorë dhe të rinjtë mund të japin mendimet e tyre në kohë të ndryshme.

Si mund të zbatohet

- vendosni rregulla të qarta se kush e monitoron platformën dhe cilat janë afatet e pritshme të përgjigjes; dhe
- mbylleni ciklin e komunikimit duke raportuar se si janë përdorur kontributet e marra.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Zgjeron pjesëmarrjen përtej atyre që kanë mundësi të marrin pjesë në takimet e planifikuara.

Shërbime të Informacionit Rinor dhe TIK-ut

Çfarë është

Shërbime vendore informacioni ose këshillimi për të rinjtë dhe mjete digjitale që një bashki përdor si pjesë e punës së saj për pjesëmarrjen rinore.

Si mund të zbatohet

- hartëzoni informacionin rinor që ekziston tashmë në nivel vendor (një qendër rinore, një sportel informacioni i bashkisë) përpara krijimit të një kanali të ri;
- vendosni standarde bazë cilësie për saktësinë dhe shpeshtësinë e përditësimit; dhe
- trajtoni në mënyrë aktive boshllëqet në qasje (mungesë interneti, mungesë aftësish digjitale), në vend që të supozoni se të gjithë kanë qasje.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Ndihmon që bashkëpunimi të mos kufizohet vetëm tek të rinjtë që janë tashmë online dhe të informuar, ndërkohë që mban aktorët rinorë të informuar për mundësitë dhe boshllëqet në nivel vendor.

5.1.4 Bashkëpunim Financiar dhe i Bazuar në Burime

Bashkëpunim i mbështetur në burime të përbashkëta dhe jo vetëm në planifikim ose diskutim. Ky model tregon nëse institucionet janë të gatshme të ndajnë jo vetëm idetë, por edhe burimet dhe vendimmarrjen.

Buxhetimi Rinor me Pjesëmarrje

Çfarë është

Bashkia zhvillon konsultime që synojnë ekskluzivisht popullatën e saj rinore dhe nevojat e tyre.

Si mund të zbatohet

- siguroni një zë të përcaktuar buxhetor nga bashkia përpara nisjes së procesit;
- publikoni një thirrje të hapur për propozime ose alternativa buxhetore; dhe
- zhvilloni një proces transparent votimi ose përzgjedhjeje dhe raportoni rezultatet.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

E shndërron një marrëdhënie këshillimore në një vendim të dukshëm, në të cilin të rinjtë kanë kontribuar drejtpërdrejt.

Grante për të Rinjtë

Çfarë është

Grante të vogla të udhëhequra nga të rinjtë, të cilat shpërndajnë fonde bashkiake ose të donatorëve për nisma të propozuara nga të rinjtë.

Si mund të zbatohet

- dakordësoni së bashku kriteret e përzgjedhjes, me një panel ku shumicën e përbëjnë të rinjtë;
- publikoni një thirrje të hapur, në mënyrë që pjesëmarrja të mos kufizohet vetëm në rrjetin e KVR-së;
- kërkoni raportim të thjeshtë dhe proporcional nga nismat e financuara.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

U jep të rinjve një rol të drejtpërdrejtë në dhënien e granteve, në vend që ata vetëm të këshillojnë të tjerët për mënyrën se si duhet të përdoren fondet.

Marrëveshje për Bashkëfinancim dhe të Burimeve ekzistuese

Çfarë është

Një aktor kontribuon me hapësirë, kohë pune të stafit ose pajisje në këmbim të financimit bashkiak ose mbështetjes për një aktivitet.

Si mund të zbatohet

- vlerësoni në mënyrë të qartë kontributin në natyrë, në mënyrë që ai të njihet krahas financimit në para;
- përcaktoni me shkrim se çfarë ofron secila palë dhe për sa kohë.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

U mundëson aktorëve më të vegjël, që nuk kanë buxhete në para, të marrin pjesë si partnerë të barabartë duke kontribuar me burime të tjera.

5.1.5 Bashkëpunim për Ngritjen e Kapaciteteve

Trajnime të përbashkëta, mentorim ose shkëmbime të shkurtra që synojnë të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për modelet e tjera të bashkëpunimit dhe jo të zbatojnë një nismë të vetme të caktuar.

Trajnime të Përbashkëta

Çfarë është

Sesione të shkurtra dhe praktike ku stafi bashkiak dhe anëtarët e KVR-së mësojnë nga njëri-tjetri, për shembull për ciklin e buxhetit bashkiak, kontaktimin dhe angazhimin e të rinjve ose metodat e angazhimit digjital.

Si mund të zbatohet

- identifikoni së bashku boshllëqet nga të dyja palët, në vend që të supozoni se vetëm të rinjtë kanë nevojë për trajnim;
- planifikoni sesionet afër periudhës së rinovimit të anëtarësisë së KVR-së;
- identifikoni kush mund tíu ofroj trajnim.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Zvogëlon boshllëqet në njohuri ndërmjet përfaqësuesve të rinj dhe aktorëve institucionalë.

Mentorim dhe Shkëmbime ndërmjet Anëtarëve/Stafit

Çfarë është

Rrjetëzimi i anëtarëve me përvojë dhe anëtarëve më të rinj të KVR-së, ose i anëtarëve të KVR-së me staf bashkiak, përmes një mentorimi të thjeshtë dhe të vazhdueshëm, në vend të një trajnimi të vetëm.

Si mund të zbatohet

- bashkoni anëtarët në largim dhe anëtarët e rinj të KVR-së përpara çdo rinovimi;
- mbajeni këtë formë bashkëpunimi të thjeshtë, kontakte të shkurtra dhe të rregullta, jo një kurrikulë formale.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Ruan njohuritë institucionale gjatë ndryshimit të anëtarësisë, në mënyra që një trajnim i vetëm nuk mund t'i sigurojë.

5.1.6 Bashkëpunim për Kërkim dhe Monitorim

Studime, vlerësime nevojash dhe vlerësime të përbashkëta ose të udhëhequra nga të rinjtë, të cilat forcojnë bazën e evidencës për modelet e tjera të bashkëpunimit.

Vlerësime të Përbashkëta të Nevojave dhe Kërkim Vendor

Çfarë është

KVR-ja dhe një partner bashkiak ose një partner nga radhët e aktorëve të tjerë përcaktojnë së bashku një pyetje kërkimore, për shembull, pengesat ndaj punësimit të të rinjve ose përdorimi i një hapësire rinore vendore dhe hartojnë një metodologji të thjeshtë.

Si mund të zbatohet

- mbajeni metodologjinë proporcionale me nevojën (një anketë e shkurtër ose disa fokus-grupe, jo një studim i madh);
- paraqitini gjetjet së bashku pranë drejtorisë përkatëse si bazë për një ndërhyrje të caktuar.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

U jep të rinjve një rol të besueshëm dhe të bazuar në evidencë në vendimmarrje, përtej shprehjes së thjeshtë të një mendimi.

<u>Monitorim dhe Vlerësim i Udhëhequr nga të Rinjtë</u>

Çfarë është

Të rinjtë udhëheqin vlerësimin e një shërbimi, hapësire ose politike ekzistuese të orientuar drejt të rinjve, në vend që të jenë vetëm përfituesit që vlerësohen.

Si mund të zbatohet

- dakordësoni mbi temën dhe planin e punës;
- dakordësoni paraprakisht se çfarë do të bëhet me gjetjet;
- siguroni për vlerësuesit e rinj mbështetje metodologjike të lehtë, kur është e nevojshme.

Si e mbështet bashkëpunimin ndërmjet KVR-së dhe aktorëve rinorë

Krijon një urë drejt modeleve të tjera të bashkëpunimit, pasi gjetjet mund të çojnë drejtpërdrejt në krijimin e një grupi pune, një diskutim këshillimor ose një propozim buxhetor.

Së bashku, këto gjashtë lloje mbulojnë dimensionet kryesore të bashkëpunimit: strukturën, zbatimin, burimet e përbashkëta, aftësitë dhe evidencën. Një KVR nuk ka nevojë të përdorë çdo metodë me çdo partner. Metodat duhet të përzgjidhen dhe kombinohen në varësi të nivelit të zhvillimit të marrëdhënies dhe nevojave të nismës.

Lista e Kontrollit

☐ Kemi zgjedhur modelin ose modelet e bashkëpunimit që i përshtaten partnerit dhe nismës.

☐ Çdo marrëveshje nënshkruhet nga pala e duhur (drejtoria, bashkia ose me vendim të këshillit bashkiak) dhe respekton statusin këshillimor të KVR-së.

☐ Çdo partner ka një person kontakti të emëruar dhe një kontribut të dakordësuar kohe ose burimesh.

☐ Mjetet digjitale mund të përdoren nga të gjithë partnerët, përfshirë ata me qasje të kufizuar në internet.

☐ Kemi një datë për rishikimin ose rinovimin e bashkëpunimit.

6. Udhëzues Hap pas Hapi për Planifikimin e Nismave të Përbashkëta

Cilido qoftë modeli nga Seksioni 5 që përdoret, suksesi i një nisme të përbashkët shpesh varet më shumë nga mënyra se si menaxhohet sesa nga ideja. Cikli i projektit ofron një mënyrë të thjeshtë për ta organizuar këtë punë.

Ky kapitull e paraqet ciklin e një projekti hap pas hapi. Përshtateni atë me kontekstin, kapacitetet dhe burimet tuaja. Ai është një pikënisje, jo një rregullore.

Cikli i projektit e trajton një nismë si një cikël dhe jo si një detyrë të vetme: mësimet nga një nismë ndikojnë në hartimin e nismës tjetër. Kjo ndjek logjikën e qasjes së Komisionit Evropian për Menaxhimin e Ciklit të Projektit (PCM), që përdoret gjerësisht në projektet e financuara nga BE-ja dhe donatorët (European Commission, 2004), mbështetet te T-Kit 3 i Këshillit të Evropës për menaxhimin e projekteve (Imre & Schëeitzer, 2026) dhe përputhet me grupet e proceseve që përdoren në praktikën e përgjithshme të menaxhimit të projekteve (Project Management Institute, n.d.). Katër fazat më poshtë e përshtatin këtë cikël për bashkëpunimin e KVR-ve. Monitorimi nuk është një fazë e veçantë pas zbatimit: ai zhvillohet paralelisht me të, siç tregon Figura 1. Cikli mund të zbatohet nga KVR-të me nivele të ndryshme përvoje.




Figura 1. Cikli i projektit për nismat e përbashkëta të KVR-së (Monitorimi zhvillohet paralelisht me Zbatimin).

Shënim mbi burimin/përshtatjen: Kjo strukturë është përshtatur për KVR-të nga Udhëzimet e Komisionit Evropian për Menaxhimin e Ciklit të Projektit (2004) dhe nga T-Kit 3: Project Management i Këshillit të Evropës (2026). Përdorni Modelin e Projektit në Aneksin 1 për të regjistruar rezultatet e secilës fazë.

1. Hartimi

Çfarë nënkupton

Hartimi e shndërron një nevojë ose mundësi që prek të rinjtë në një plan konkret dhe të përbashkët: çfarë do të bëhet, për kë, pse dhe me çfarë rezultati të pritshëm. Ai është themeli i të gjithë ciklit. Boshllëqet në këtë fazë – si një objektiv i paqartë ose një partner që nuk është konsultuar, shpesh rishfaqen më vonë dhe janë më të vështira për t'u korrigjuar.

Elementet kryesore të fazës së hartimit

Objektivi: ndryshimi specifik që nisma synon të sjellë, i formuluar në mënyrë mjaftueshëm të qartë që të mund të vlerësohet nëse është arritur. Për shembull, "Përmirësimi i punësimit të të rinjve" është tepër i gjerë; "30 të rinj përfundojnë një seminar për hartimin e CV-së dhe aftësitë për intervistë deri në qershor" është specifik, i thjeshtë dhe i matshëm.

Afati kohor: kalendari i përgjithshëm i nismës, nga Hartimi deri te Përmbyllja. Ai është një kalendar i vetëm i përbashkët që përfshin datën e fillimit, piketat kryesore dhe datën e përfundimit. Dakordësimi i tij gjatë Hartimit dhe kontrolli i tij gjatë Monitorimit ndihmojnë në parandalimin e vonesave dhe të përfundimeve të paqarta.

Buxheti dhe burimet: një pasqyrë e asaj që do të kushtojë nisma dhe e asaj që i nevojitet përtej parave, si ambienti, koha e stafit ose e vullnetarëve, mjetet digjitale, trajneri/rja dhe materialet e printuara. Këto burime duhet të konfirmohen dhe jo të supozohen përpara se të fillojë Zbatimi.

Rolet dhe përgjegjësitë: një përcaktim i qartë se kush është përgjegjës për secilën pjesë të nismës dhe kush ka autoritetin përfundimtar vendimmarrës kur partnerët nuk bien dakord. Përgjegjësitë duhet t'u caktohen personave me emër dhe të mos lihen në pritshmërinë e përgjithshme se "KVR-ja" ose "partnerët" do t'i menaxhojnë ato.

Produktet konkrete: rezultatet konkrete që do të prodhojë nisma, si një trajnim i zhvilluar, një raport i publikuar ose një propozim i paraqitur pranë këshillit bashkiak.

Si zbatohet

- zhvilloni një vlerësim të shkurtër të nevojave, një anketë të shkurtër, një fokus-grup ose një konsultim joformal me të rinjtë që nisma synon të arrijë, në vend që të supozoni se çfarë u nevojitet;
- formuloni një objektiv të qartë (çfarë duhet të ndryshojë) dhe dy ose tre rezultate të pritshme të matshme (si do ta kuptoni që ndryshimi ka ndodhur);
- identifikoni partnerët e nevojshëm dhe atë që secili prej tyre do të kontribuojë, si kohë, hapësirë, buxhet ose ekspertizë;
- përcaktoni afatin e përgjithshëm kohor të nismës: datën e fillimit, piketat kryesore dhe datën e përfundimit;
- konfirmoni buxhetin dhe burimet e tjera, dakordësoni kush është përgjegjës për çfarë dhe regjistroni objektivin, partnerët, afatin kohor, buxhetin dhe përgjegjësitë në një plan të thjeshtë, duke përdorur Modelin e Projektit në Aneksin 1.

2. Zbatimi dhe Monitorimi

Çfarë nënkupton

Zbatimi është faza e realizimit. Aktivitetet e dakordësuara gjatë Hartimit zhvillohen: mbahen sesionet, prodhohen materialet, përdoren burimet dhe partnerët koordinohen me njëri-tjetrin. Plani duhet të udhëheqë realizimin, por duke lejuar përshtatje të arsyeshme sipas rrethanave që ndryshojnë. Monitorimi zhvillohet në të njëjtën kohë, dhe jo më pas: ai ndjek progresin në raport me planin e Hartimit gjatë gjithë realizimit, në mënyrë që problemet të kapen ndërkohë që ende mund të korrigjohen.

Si zbatohet

- konfirmoni planin e detajuar të aktiviteteve në përputhje me afatin kohor të dakordësuar gjatë Hartimit (datat, ambientet, kush bën çfarë) dhe ndajeni atë me çdo partner përpara fillimit;
- caktoni një person të identifikuar me emër si përgjegjës për secilin aktivitet ose detyrë, në mënyrë që përgjegjësia të mos jetë asnjëherë e paqartë;
- krijoni forma të thjeshta koordinimi mes partnerëve, që kërkojnë pak kohë dhe përpjekje (një grup i përbashkët komunikimi, një përditësim javor me dy rreshta); dhe
- mbani vazhdimisht shënime për atë që është realizuar datat, pjesëmarrjen, shpenzimet, ndërkohë që ndodh, dhe jo t'i rindërtoni më vonë.

Monitorimi (paralelisht me zbatimin)

Monitorimi është ndjekja e vazhdueshme e progresit ndërsa nisma është në zhvillim, përfshirë aktivitetet dhe shpenzimet në raport me planin e Hartimit. Ai zhvillohet në të njëjtën kohë me zbatimin, dhe jo pas tij. Kur bëhet mirë, ai i identifikon problemet mjaft herët për të ndërmarrë veprime korrigjuese.

- mbani një tabelë të thjeshtë ndjekjeje që krahason datat, aktivitetet dhe shpenzimet e planifikuara me ato faktike, duke i kontrolluar kundrejt afatit kohor të përcaktuar gjatë Hartimit;
- zhvilloni takime të shkurtra kontrolli me partnerët në intervale të rregullta dhe të përcaktuara, të fokusuara vetëm në atë që ka ndryshuar që nga takimi i fundit; dhe
- dokumentoni çdo devijim nga plani së bashku me masën korrigjuese të dakordësuar, në mënyrë që arsyetimi të mos humbasë.

3. Vlerësimi

Çfarë nënkupton

Vlerësimi shqyrton nëse rezultatet e përcaktuara gjatë Hartimit janë arritur dhe pse janë arritur ose jo. Ai zhvillohet pasi aktivitetet kanë përfunduar dhe ndryshon nga monitorimi, i cili ndjek progresin gjatë zbatimit.

Si zbatohet

- krahasoni rezultatet faktike drejtpërdrejt me objektivin dhe rezultatet e pritshme të përcaktuara gjatë Hartimit;

- kontrolloni nëse nisma është realizuar brenda afatit kohor dhe buxhetit të dakordësuar dhe evidentoni ku dhe pse kjo nuk ka ndodhur;
- mblidhni reagime nga pjesëmarrësit dhe partnerët përmes një ankete të shkurtër[1] ose një diskutimi përmbyllës, përfshirë atë që nuk funksionoi dhe jo vetëm atë që funksionoi; dhe
- përgatitni një përmbledhje të shkurtër të vlerësimit; zakonisht një faqe është e mjaftueshme dhe ka më shumë gjasa të lexohet sesa një raport i gjatë.

4. Përmbyllja dhe Mësimet e Nxjerra

Çfarë nënkupton

Përmbyllja e përfundon formalisht nismën dhe dokumenton atë që është mësuar. Ajo e shndërron një projekt në pikënisjen e projektit të ardhshëm dhe e plotëson ciklin duke u kthyer te Hartimi.

Si zbatohet

- zhvilloni një diskutim të shkurtër të përbashkët me partnerët, të fokusuar posaçërisht në mësimet e nxjerra, të ndarë nga vlerësimi i rezultateve;
- dokumentoni këto mësime, edhe shkurtimisht, në vend që t'i lini si përshtypje joformale të personave që kanë qenë të përfshirë;
- vendosni së bashku nëse bashkëpunimi duhet të përsëritet, të zgjerohet ose të formalizohet më tej (për shembull, duke kaluar nga një partneritet joformal për një fushatë në një grup të përhershëm të përbashkët pune); dhe
- ruani përmbledhjen e nismës, afatin kohor, dokumentacionin dhe vlerësimin në një vend ku anëtarët e ardhshëm të KVR-së mund t'i gjejnë, në mënyrë që nisma të mos humbasë me rinovimin e ardhshëm të anëtarësisë.

Lista e Kontrollit

☐ Hartimi: një objektiv i qartë, afati kohor, buxheti, rolet dhe produktet konkrete janë shkruar në modelin e Aneksit 1.

☐ Zbatimi dhe Monitorimi: çdo aktivitet ka një person përgjegjës të emëruar dhe progresi ndiqet në intervale të rregullta.

☐ Vlerësimi: rezultatet krahasohen me objektivin, duke përdorur modelet e Aneksit 3.

☐ Përmbyllja dhe Mësimet e Nxjerra: mësimet janë shkruar dhe arkivuar, dhe është marrë një vendim për hapat e ardhshëm.

7. Komunikimi dhe Dukshmëria


Komunikimi është thelbësor për çdo nismë, pavarësisht nga shkalla e saj ose nga kush e drejton. Komunikimi i mirë i ndihmon njerëzit të kuptojnë qëllimin e një nisme, mënyrën se si mund të

[1] Modelet jepen në Aneksin 3.

marrin pjesë dhe rolin që kanë në të. Ai mund të ndihmojë gjithashtu në krijimin e një mbështetjeje më të gjerë me kalimin e kohës.

Një mjet i dobishëm komunikimi është lista e kontrollit 5W+1H: pesë pyetje që fillojnë me Ë (Ëho, What, Why, When, Where) dhe një që fillon me H (How). Ajo ofron një mënyrë të thjeshtë për të planifikuar çdo aktivitet komunikimi ose advokimi.

Who? – Kush? Kush duhet ta marrë mesazhin?
What? – Çfarë? Çfarë duam të komunikojmë?
Why? – Pse? Pse është e rëndësishme nisma?
When? – Kur? Kur duhet të ndahet informacioni?
Where? – Ku? Ku do ta gjejnë të rinjtë informacionin?
How? – Si? Si mund të marrin pjesë ose të japin mendimin e tyre?



Kanalet e Kontaktimit dhe Angazhimit

Mos u mbështetni vetëm te të rinjtë që janë tashmë aktivë në organizata rinore, këshilla ose struktura të tjera formale. Përdorni kanale të ndryshme dhe partnerë vendorë për të arritur ata që kanë më pak mundësi për të marrë pjesë, përfshirë të rinjtë në zonat rurale, të rinjtë NEET, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të tjerë që përballen me pengesa sociale ose ekonomike.

Kontaktimi dhe angazhimi gjithëpërfshirës përdor gjuhë të qartë, të thjeshtë dhe të aksesueshme dhe nuk mbështetet vetëm te organizatat rinore formale për shpërndarjen e informacionit. Ai punon gjithashtu përmes aktorëve vendorë të besuar që tashmë kanë kontakt me grupet më pak të dukshme dhe përdor formate që janë të lehta për t'u kuptuar dhe aksesuar, përfshirë në zonat rurale ose të largëta. Kur është e përshtatshme, pjesëmarrja duhet të jetë e mundur si online, ashtu edhe fizikisht, duke u ofruar të rinjve më shumë se një mënyrë për të dhënë mendimin e tyre.

Në praktikë, kontaktimi dhe angazhimi mund të përdorë shkollat dhe institucionet arsimore, qendrat rinore, hapësirat komunitare dhe organizatat vendore. Mediat sociale dhe platformat online mund ta zgjerojnë më tej këtë shtrirje, ndërsa shërbimet e punësimit dhe të arsimit profesional janë të dobishme kur një nismë lidhet me punën ose trajnimin. Kontaktimi i drejtpërdrejtë përmes punonjësve rinorë, aktorëve vendorë të besuar dhe profesionistëve të tjerë mund të arrijë të rinj që nuk arrihen përmes kanaleve të tjera.

Përpara publikimit ose shpërndarjes së informacionit, kontrolloni që mesazhi të jetë i qartë dhe i qëndrueshëm, audienca të jetë e përcaktuar mirë dhe të gjithë partnerët të përfaqësohen saktë. Kanalet e zgjedhura duhet gjithashtu të arrijnë të rinjtë që janë më pak të dukshëm ose më të vështirë për t'u përfshirë. Duhet të jetë e qartë se si mund të marrin pjesë njerëzit dhe çfarë ndodh më pas.

Dukshmëria dhe bashkëbrendimi

Dakordësoni që në fillim se si do të jetë i dukshëm secili partner. Shfaqni emrat dhe logot e të gjithë partnerëve në mënyrë të drejtë dhe të njëtrajtshme, dhe njihni bashkinë dhe çdo financues që mbështet nismën. Kur një nismë financohet nga një donator, ndiqni kërkesat e tij për dukshmërinë, si mirënjohjet ose logot e kërkuara; donatori ose bashkia mund të tregojnë çfarë zbatohet. Mos përdorni emrin ose logon e një partneri tjetër pa pëlqimin e tij.

Koordinimi dhe rolet në komunikim

Për nismat e përbashkëta, partnerët duhet të dakordësohen paraprakisht:

- kush përgatit materialet e komunikimit;
- kush i miraton mesazhet para publikimit;
- cili partner publikon përmes cilave kanale;
- si shfaqen emrat dhe identiteti vizual i partnerëve;
- kush u përgjigjet pyetjeve, komenteve ose kërkesave të medias.

Mjeti Praktik 1: Plani i Thjeshtë i Komunikimit

Mesazhi dhe qëllimi	Audienca	Kanali	Përgatitet nga	Miratohet nga	Publikohet nga	Kur
Thirrje për pjesëmarrës në një forum rinor	Të rinj 15–29 vjeç, përfshirë të rinjtë nga zonat rurale	Shkollat, qendra rinore, rrjetet sociale	Organizata Rinore A	Bashkëkryetarët e KVR-së	KVR-ja dhe Organizata Rinore A	Tri javë përpara ngjarjes

Mesazhi dhe qëllimi	Audienca	Kanali	Përgatitet nga	Miratohet nga	Publikohet nga	Kur
Përmbledhje e asaj që ndodhi me kontributin e të rinjve	Pjesëmarrësit e forumit dhe bashkia	Të njëjtat kanale si thirrja	Sekretariati i KVR-së	Bashkëkryetarët e KVR-së	KVR-ja	Brenda një muaji pas ngjarjes

Zhvilluar për këtë Udhëzues: Rreshtat janë ilustrues; çdo KVR duhet ta plotësojë planin e vet për çdo nismë.

Pëlqimi dhe mbrojtja e të dhënave

Kur komunikimi përfshin fotografi, video, histori personale ose informacion tjetër personal për të rinjtë, duhet të respektohen kërkesat e duhura për pëlqimin dhe mbrojtjen e të dhënave. Kujdes i veçantë duhet treguar kur komunikohet për të mitur (nën 18 vjeç) ose për të rinj në situata të cenueshme: merrni pëlqimin e prindërve ose të kujdestarëve kur kërkohet, shpjegoni si do të përdoret materiali dhe respektoni dëshirën e personit për ta tërhequr atë. Shihni gjithashtu parimin për mbrojtjen dhe mbrojtjen e të dhënave në Kapitullin 3.

Mbyllja e ciklit të reagimeve

Të rinjtë që marrin pjesë në aktivitete reagimi duhet të mund të shohin se çfarë ndodhi me kontributin e tyre. Pas një konsultimi, ankete ose takimi, ndani një përmbledhje të shkurtër të asaj që u tha, çfarë do të bëhet dhe çfarë nuk do të bëhet e pse, duke përdorur të njëjtat kanale që u përdorën për mbledhjen e reagimeve.

Lista e Kontrollit

- ☐ Kemi plotësuar pyetjet 5Ë+1H dhe planin e komunikimit (Mjeti Praktik 1).
- ☐ Rolet për përgatitjen, miratimin dhe publikimin e mesazheve janë dakordësuar.
- ☐ Emrat dhe logot e partnerëve dhe të financuesve shfaqen saktë dhe me lejen e tyre.
- ☐ Kemi marrë pëlqimin përpara se të përdornim foto, video ose histori (nga prindërit ose kujdestarët për të miturit).
- ☐ U kemi thënë pjesëmarrësve se çfarë ndodhi me reagimet e tyre.

8. Menaxhimi i Rreziqeve dhe Zgjidhja e Konflikteve

8.1. Zbutja e Rreziqeve gjatë Zbatimit të Projektit

Zbutja e rreziqeve nënkupton planifikimin paraprak për të zvogëluar mundësinë ose ndikimin e problemeve. Qëllimi nuk është të parashikohet çdo vështirësi e mundshme, por të identifikohen herët rreziqet e rëndësishme dhe të dakordësohet mënyra se si ato mund të parandalohen ose trajtohen.

T-Kit 3 i Këshillit të Evropës, botimi 2026, jep shembuj të rreziqeve në projekte dhe të masave për zbutjen e tyre. Për shembull, ai identifikon pjesëmarrjen e pamjaftueshme si një rrezik të mundshëm dhe sugjeron si masa parandaluese kontaktimin e hershëm me aktorët, përdorimin e

rrjeteve të partnerëve, kontaktimin e synuar dhe listat e pritjes. Ai rekomandon gjithashtu përshtatjen e periudhave të rekrutimit ose riplanifikimin e aktiviteteve kur është e nevojshme.

<u>Për zbutjen e rreziqeve mund të përdoret një metodë e thjeshtë me dy hapa:</u>

Hapi 1. Pyetni: "Çfarë mund të na pengojë të kemi sukses?"

Gjatë takimit të planifikimit, pyetni secilin partner:

Çfarë mund ta pengojë këtë nismë të arrijë objektivat e saj?

Regjistroni përgjigjet dhe jepuni përparësi rreziqeve më të rëndësishme.

Mjeti Praktik 2: Regjistri i Rreziqeve të KVR-së

Rreziku	Gjasat	Ndikimi	Parandalimi	Përgjegjësi	Reagimi
Pjesëmarrje e ulët e të rinjve	Mesatare	I lartë	Kontaktim i hershëm, ambasadorë nga radhët e bashkëmoshatarëve	Përgjegjësi i kontaktimit	Zgjatja e afatit të regjistrimit
Partneri e humbet afatin	Mesatare	Mesatar	Përgjegjësi të qarta	Koordinatori	Ridhënia e detyrës
Kontribut i pabarabartë	Mesatare	I lartë	Angazhime me shkrim	Koordinatori	Rishikimi i ngarkesës
Konflikt komunikimi	Mesatare	Mesatar	Protokoll komunikimi	Përgjegjësi i komunikimit	Takim i lehtësuar
Vonesë në financim	E ulët/Mesatare	I lartë	Planifikim për raste të paparashikuara	Përgjegjësi i financave	Përshtatja e aktiviteteve
Incident mbrojtjeje ose mbrojtjeje të të dhënave që përfshin një të mitur	E ulët/Mesatare	I lartë	Formularë pëlqimi; person i caktuar për mbrojtjen; pëlqim për foto dhe video	Personi i kontaktit për mbrojtjen	Ndalimi i aktivitetit; njoftimi i prindërve ose kujdestarëve dhe i autoritetit përgjegjës

Shënim mbi burimin/përshtatjen: Struktura është përshtatur për KVR-të nga qasja e menaxhimit të rreziqeve dhe shembujt e paraqitur në T-Kit 3: Project Management. Rreziqet dhe shembujt specifikë në këtë tabelë janë zhvilluar për këtë Udhëzues.

Hapi 2. Qartësoni Përgjegjësitë për të Parandaluar Rrezikun

Shumë probleme në partneritete lindin nga interpretime të ndryshme të përgjegjësive.

Për çdo detyrë të rëndësishme, përcaktoni:

Kush e bën? Deri kur? Me çfarë burimesh? Kush e miraton?

Shembull

Detyra: Rekrutimi i 50 pjesëmarrësve të rinj
Përgjegjësi: Organizata Rinore A
Mbështetja: KVR + shkollat
Afati: 15 tetor
Synimi: 50 regjistrime, duke përfshirë të rinj nga grupe të nënpërfaqësuara.

Kjo e shndërron një angazhim të paqartë, si "Partneri A do të mbështesë rekrutimin", në një përgjegjësi të qartë dhe të matshme.

Zhvilluar për këtë Udhëzues: Ky shembull është ilustrues dhe ndjek parimet e planifikimit të projektit dhe menaxhimit të detyrave të paraqitura në T-Kit 3.

8.2. Zgjidhja e Konflikteve

Mosmarrëveshjet janë pjesë normale e punës me njerëz, organizata ose institucione që kanë mandate, burime dhe përparësi të ndryshme. Qëllimi është që ato të trajtohen në mënyrë konstruktive, në mënyrë që të mos dëmtojnë nismën e përbashkët. Bashkëpunimi efektiv nuk kërkon që partnerët të bien dakord për gjithçka; ai kërkon mënyra të dakordësuara për të komunikuar, për të marrë vendime dhe për të trajtuar mosmarrëveshjet.

Parimi Kryesor për Zgjidhjen e Konflikteve: Trajtoni çështjen, jo personin. Qartësoni faktet, kuptoni interesat, dakordësoni një zgjidhje praktike dhe dokumentoni vendimin.

Duke u mbështetur në T-Kit 12 të Këshillit të Evropës: Youth Transforming Conflict dhe në burime të tjera në dispozicion, ky protokoll me gjashtë hapa mund të përdoret për të kaluar një konflikt:

1. Qartësoni çështjen
Çfarë ndodhi? Për cilat fakte ka dakordësi?

2. Dëgjoni këndvështrimin e secilës palë
Çfarë thotë secili partner se ka ndodhur?

3. Identifikoni nevojat dhe interesat
Çfarë i nevojitet secilit partner për të ecur përpara?

4. Zhvilloni zgjidhje
Cilat janë të paktën tri zgjidhje të mundshme?

5. Dakordësoni veprimet
Kush do të bëjë çfarë dhe deri kur?

6. Ndiqni zbatimin
A ka funksionuar zgjidhja?

Kujtesë përmbyllëse: Kujtoni pse e nisët dhe çfarë ka vërtet rëndësi.

Lista e Kontrollit

- ☐ Rreziqet u diskutuan me të gjithë partnerët në fazën e planifikimit, përfshirë rrezikun politik dhe mbrojtjen e të rinjve.
- ☐ Çdo rrezik ka një përgjegjës dhe një masë reagimi.
- ☐ Për çdo detyrë të rëndësishme kemi dakordësuar kush e bën, deri kur, me çfarë burimesh dhe kush e miraton.
- ☐ Kemi dakordësuar si do t'i trajtojmë mosmarrëveshjet përpara se të lindin.

9. Monitorimi, Vlerësimi dhe Qëndrueshmëria

Monitorimi, vlerësimi dhe qëndrueshmëria janë të rëndësishme për çdo nismë, qoftë ajo një projekt, aktivitet apo politikë. Monitorimi ndjek progresin ndërkohë që puna është në zhvillim. Vlerësimi shqyrton se sa mirë ka funksionuar nisma dhe ku kanë mbetur boshllëqe ndërmjet asaj që ishte planifikuar dhe asaj që është arritur. Qëndrueshmëria shqyrton atë që vazhdon pasi nisma përfundon.

Së bashku, këta tre elementë ndihmojnë KVR-të dhe partnerët e tyre të nxjerrin mësime nga zbatimi, të përmirësojnë bashkëpunimin e ardhshëm dhe të ruajnë me kalimin e kohës praktikat që rezultojnë të dobishme.

9.1. Monitorimi

Monitorimi është ndjekja e rregullt e një nisme ndërkohë që ajo është duke u zbatuar. Ai ndihmon KVR-në dhe partnerët e saj të kontrollojnë nëse aktivitetet po zhvillohen sipas planit, nëse burimet po përdoren sipas marrëveshjes dhe nëse progresi po ecën drejt rezultateve të pritshme.

Monitorimi i mirë duhet të jetë i thjeshtë, i rregullt dhe proporcional me shkallën e nismës. Ai duhet të sigurojë informacion të mjaftueshëm për të identifikuar herët problemet dhe për të mbështetur përshtatjet në kohën e duhur, pa krijuar raportim të panevojshëm.

Në praktikë, monitorimi mund të përqendrohet në një numër të vogël pyetjesh kryesore:

- **Aktivitetet:** A po zhvillohen aktivitetet e planifikuara sipas afatit?
- **Pjesëmarrja:** A po arrihen dhe po marrin pjesë të rinjtë e synuar?
- **Progresi:** A kanë filluar të shfaqen rezultatet e pritshme?
- **Burimet:** A po përdoren koha, buxheti dhe burimet e tjera sipas planit?
- **Përgjegjësitë:** A po i kryejnë partnerët detyrat për të cilat kanë rënë dakord?
- **Sfidat:** Çfarë problemesh ose vonesash kanë lindur dhe çfarë mase korrigjuese nevojitet?

Informacioni i monitorimit mund të mblidhet përmes mjeteve të thjeshta, si lista e pjesëmarrjes, tabelat për ndjekjen e aktiviteteve, përditësimet e shkurtra nga partnerët, kontrollet e buxhetit dhe reagimet e shkurtra nga pjesëmarrësit.

Monitorimi nuk duhet vetëm të regjistrojë atë që ka ndodhur. Ai duhet gjithashtu të mbështesë veprimin. Kur progresi ndryshon nga plani, KVR-ja dhe partnerët e saj duhet të dakordësojnë se çfarë duhet të ndryshojë, kush është përgjegjës dhe deri kur.

Procesi i monitorimit duhet të lidhet drejtpërdrejt me vlerësimin. Të dhënat dhe dokumentacioni i mbledhur gjatë zbatimit ofrojnë evidencë për vlerësimin e rezultateve në fund të nismës.

9.2. Vlerësimi

Një vlerësim i mirë ndjek disa parime kryesore: anonimitetin dhe konfidencialitetin, gjuhën e thjeshtë, objektivitetin dhe ndjekjen e asaj që mësohet. Dy modele jepen në Aneksin 3.

Parimet dhe modelet e bashkëpunimit marrin kuptim vetëm kur rezultatet e tyre ndiqen me kalimin e kohës. Ky seksion përdor "4 Ws of Evaluation" të SALTO-YOUTH si një kuadër të thjeshtë për të përcaktuar se çfarë duhet të vlerësohet në një nismë të përbashkët.

4 Ws of Evaluation (SALTO-YOUTH)

"4 Ws of Evaluation" të SALTO-YOUTH, ´´Why, What, Who dhe When´´ ofrojnë një strukturë të thjeshtë që mund të përdoret nga çdo KVR, pavarësisht nga shkalla e nismës.

Why? – Pse?

Vlerësimi tregon nëse një nismë e ka arritur ndryshimin që synonte të sillte. Ai ndihmon gjithashtu në justifikimin e burimeve të përdorura dhe orienton hartimin e nismave të ardhshme.

What? – Çfarë?

- **Qëllimet dhe objektivat:** qëllimi afatgjatë i nismës dhe hapat e matshëm të përdorur për ta arritur atë. Në mënyrë ideale, këto duhet të përcaktohen që në fillim, në mënyrë që të ketë një bazë të qartë për vlerësimin.
- **Rezultatet e të nxënit:** çfarë mësuan pjesëmarrësit, cilat metoda funksionuan dhe çfarë duhet të ndryshojë në nismat e ardhshme.
- **Aspektet praktike dhe burimet:** nëse logjistika, ambienti dhe burimet ishin të përshtatshme dhe u përdorën mirë.
- **Puna në ekip dhe partneriteti:** çfarë funksionoi mirë ndërmjet KVR-së dhe partnerëve të saj dhe çfarë kontribuoi secila palë në zbatim.

Who? – Kush?

Audienca të ndryshme kanë nevojë për informacion të ndryshëm nga një vlerësim, përfshirë KVR-në, aktorët rinorë, bashkinë dhe popullatën më të gjerë rinore. Vlerësimi duhet të ofrojë informacion të besueshëm dhe të dobishëm për secilën prej tyre, dhe jo vetëm për organizatorët.

When? – Kur?

Vlerësimi duhet të zhvillohet gjatë të gjithë ciklit jetësor të një nisme dhe të përputhet me fazat e paraqitura në Kapitullin 6: vlerësimi para aktivitetit gjatë planifikimit, kur dakordësohen qëllimet dhe objektivat; vlerësimi i vazhdueshëm gjatë zbatimit, duke lejuar përshtatje; vlerësimi në përfundim të aktivitetit për rezultatet e menjëhershme dhe organizimin praktik; dhe vlerësimi vijues në një fazë të mëvonshme për të vlerësuar ndikimin afatgjatë dhe vazhdimësinë.

Kuadri mund të përshtatet sipas nismës. Dy modele të gatshme për përdorim jepen në Aneksin 3: një Formular Kënaqësie të Pjesëmarrësve dhe një Formular Vlerësimi të Aktivitetit.

9.3. Qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria lidhet me atë që mbetet pasi një nismë e vetme përfundon: nëse bashkëpunimi vazhdon apo nëse KVR-ja duhet të fillojë përsëri nga zero. Kjo pasqyron parimin e Vazhdimësisë dhe Qëndrueshmërisë në Seksionin 3, i cili kërkon struktura dhe burime të qëndrueshme dhe jo varësi nga një person i vetëm ose nga financimi i njëhershëm. Një nismë që mbështetet tërësisht te një anëtar i vetëm i angazhuar ose te një grant i vetëm ka pak gjasa të jetë e qëndrueshme pasi ai person ose ai financim të mos jetë më i disponueshëm.

Një mënyrë praktike për të mbështetur qëndrueshmërinë është procesi i dorëzimit të njohurive dhe dokumentacionit, i integruar në ciklin e projektit në Seksionin 6. Gjatë fazës së Përmbylljes dhe Mësimeve të Nxjerra, KVR-ja dokumenton mësimet dhe ruan dokumentet kryesore në një vend ku anëtarët e ardhshëm mund t'i gjejnë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ndryshon anëtarësia e KVR-së, pasi ruan kujtesën institucionale dhe i mundëson grupit pasardhës të vazhdojë punën, në vend që të rindërtojë nga e para të njëjtat marrëdhënie dhe njohuri.

Qëndrueshmëria nënkupton gjithashtu të dish se kur bashkëpunimi duhet të formalizohet. Një partneritet për një fushatë ose një aktivitet i bashkëorganizuar (Seksioni 5.1.2) mund të ketë nevojë për një bazë më formale pasi të ketë treguar se është i dobishëm. Kalimi në një Memorandum Mirëkuptimi ose në një grup të përhershëm të përbashkët pune (Seksioni 5.1.1) mund ta ndihmojë bashkëpunimin t'u mbijetojë ndryshimeve në staf, në anëtarësinë e KVR-së ose në drejtimin e bashkisë. Jo çdo nismë ka nevojë për këtë hap, por nismat që përsëriten shpesh përfitojnë prej tij.

Qëndrueshmëria financiare nënkupton që bashkëpunimi të mos varet nga financimi i njëhershëm i projekteve. KVR-të mund të punojnë me bashkinë për të përfshirë një zë buxhetor për aktivitetet rinore dhe për KVR-në në Programin Buxhetor Afatmesëm të bashkisë, dhe mund të përdorin financimin që Ligji "Për Rininë" parashikon për veprimtaritë e KVR-së nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, krahas kontributit bashkiak (neni 10, pika 2/1). Paraqitja e kësaj kërkese herët në ciklin vjetor të buxhetit, e mbështetur me evidencë nga monitorimi dhe vlerësimi, rrit gjasat që ajo të përfshihet.

9.4. Treguesit e Cilësisë së Bashkëpunimit

Treguesit e mëposhtëm e ndihmojnë një KVR dhe partnerët e saj të gjykojnë cilësinë e bashkëpunimit me kalimin e kohës. Çdo KVR duhet të zgjedhë treguesit që i përshtaten kontekstit të saj, të regjistrojë një pikënisje dhe të caktojë objektivat e veta.

Treguesi	Si matet	Burimi i mundshëm i informacionit
Nisma të përbashkëta	Numri i nismave të përbashkëta të përfunduara brenda një viti me të paktën një aktor rinor	Planet e Aneksit 1; shënimet e KVR-së
Propozime të miratuara	Pjesa e propozimeve dhe e mendimeve të KVR-së që janë miratuar ose zbatuar nga bashkia	Shënimet e KVR-së; procesverbalet e këshillit bashkiak
Larmia e pjesëmarrësve	Pjesa e pjesëmarrësve nga grupe të nënpërfaqësuara (për shembull të rinj nga zonat rurale, të rinj me aftësi të kufizuara, të rinj romë e egjiptianë, NEET, gra dhe burra), krahasuar me popullatën rinore vendore	Të dhëna regjistrimi të mbledhura me pëlqim
Propozimet e miratuara	Pjesa e propozimeve dhe e mendimeve të KVR-së që janë miratuar ose zbatuar nga bashkia	Shënimet e KVR-së; procesverbalet e këshillit bashkiak
Larmia e pjesëmarrësve	Pjesa e pjesëmarrësve nga grupe të nënpërfaqësuara (për shembull të rinj nga zonat rurale, të rinj me aftësi të kufizuara, të rinj romë e egjiptianë, NEET, gra dhe burra), krahasuar me popullatën rinore vendore	Të dhëna regjistrimi të mbledhura me pëlqim
Vlerësimi i mbledhur	Pjesa e konsultimeve ose nismave pas të cilave pjesëmarrësve u është thënë si është përdorur kontributi i tyre	Plani i komunikimit; shënimet e KVR-së
Marrëveshje me shkrim	Numri i partneriteteve me marrëveshje me shkrim (MM ose termat e referencës) dhe numri i atyre të rinovuara	Dosjet e KVR-së dhe të bashkisë
Respektimi i afatit dhe i buxhetit	Pjesa e nismave të realizuara në kohë dhe brenda buxhetit të dakordësuar	Tabela e ndjekjes; përmbledhja e vlerësimit
Qëndrueshmëria financiare	Pjesa e veprimtarisë së KVR-së që financohet nga një zë i buxhetit bashkiak ose nga fondet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë	Buxheti i bashkisë; shënimet e Agjencisë Kombëtare të Rinisë
Kënaqësia e pjesëmarrësve	Vlerësimi mesatar në formularët e Aneksit 3	Formularët e Aneksit 3

Zhvilluar për këtë Udhëzues: Këta tregues janë sugjerime që bazohen në modelet e bashkëpunimit dhe në parimet e këtij Udhëzuesi.

Lista e Kontrollit

- ☐ Pyetjet e monitorimit u dakordësuan në fillim dhe ndiqen në intervale të rregullta.
- ☐ Vlerësimi u planifikua që nga fillimi dhe formularët e Aneksit 3 janë gati.
- ☐ Kemi zgjedhur tregues nga Seksioni 9.4 dhe kemi regjistruar një pikënisje.
- ☐ Mësimet arkivohen dhe i dorëzohen anëtarësisë së re në rinovimin e radhës.
- ☐ Kemi përgatitur një kërkesë buxhetore për vitin e ardhshëm (Programi Buxhetor Afatmesëm dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë).

Referenca

Council of Europe. (n.d.). *Youth for democracy: Who does what for youth in the Council of Europe*. https://www.coe.int/en/web/portal/themes/youth

Council of Europe. (2003). *Revised European Charter on the participation of young people in local and regional life*. https://www.coe.int/en/web/youth/-/revised-european-charter-on-the-participation-of-young-people-in-local-and-regional-life

Council of Europe. (2015). *Have your say! Manual on the revised European Charter on the participation of young people in local and regional life*. https://www.coe.int/en/web/campaign-free-to-speak-safe-to-learn/-/have-your-say-manual-on-the-revised-european-charter-on-the-participation-of-young-people-in-local-and-regional-life-2015-

Council of Europe, Committee of Ministers. (2026). *Recommendation to member States on the European Charter on the Participation of Young People in Local and Regional Life* (adopted 12 March 2026). https://www.coe.int/en/web/youth/-/adopted-the-european-charter-on-the-participation-of-young-people-in-local-and-regional-life

Council of Europe & European Commission, Youth Partnership. (n.d.). *T-Kit 12: Youth transforming conflict*. https://pjp-eu.coe.int/en/web/youth-partnership/t-kit-12-youth-transforming-conflict

Council of the European Union. (2018). *Resolution on a framework for European cooperation in the youth field: The European Union Youth Strategy 2019–2027* (2018/C 456/01). Official Journal of the European Union, C 456, 1. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=OJ:C:2018:456:FULL

DYPALL Network. (2023). *Quality charter on participatory and inclusive local youth councils*. https://dypall.com/catalogue-of-resources/

European Commission. (2004). *Aid delivery methods: Project cycle management guidelines*. EuropeAid Co-operation Office.

European Commission. (n.d.). *European Youth Goals*. https://youth.europa.eu/strategy/european-youth-goals_en

European Economic and Social Committee. (2024). Structured and meaningful youth participation in policy and decision-making processes (Study No. QE-01-24-004-EN-N). https://www.eesc.europa.eu/en/our-work/publications-other-work/publications/structured-and-meaningful-youth-participation-policy-and-decision-making-processes-mapping-local-national-eu-and

European Youth Portal. (2024). *EU Youth Strategy*. https://youth.europa.eu/strategy/

Hart, R. A. (1992). *Children's participation: From tokenism to citizenship*. UNICEF International Child Development Centre.

Imre, S.-B., & Schweitzer, S. (2026). *T-Kit 3: Project management* (2nd ed.). Council of Europe Publishing. https://doi.org/10.3917/e.europ.coe.2026.03

Lula, L. (2023). *Contribution of partner countries to the EU Youth Wiki, Chapter V: Albania – Participation*. EU–Council of Europe Youth Partnership. https://pjp-eu.coe.int/documents/42128013/58896112/Albania_Chapter%20V.pdf/4671eafe-3a79-ed0d-43a4-386177338abc?t=1712841866262

Ministry of State for Youth and Children. (2022). *National Youth Strategy and Action Plan 2022–2029*. Tirana. https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/SKR29_Anglisht.pdf

Muço, F. (2024). *Mapping of youth policies and identification of existing support and gaps in financing of youth actions in the Western Balkans – Albania report*. Regional Cooperation Council, Western Balkans Youth Lab.

Project Management Institute. (n.d.). *A guide to the project management body of knowledge (PMBOK® Guide)*. https://www.pmi.org/pmbok-guide-standards

SALTO-YOUTH. (n.d.). *The 4 W's of evaluation: Why? What? Who? When?*. https://www.salto-youth.net/tools/evaluation/the4ws/

World Future Council. (2019). *Council of Europe's co-management of the youth sector* (Future Policy Bronze Award 2019). https://www.futurepolicy.org/global/council-of-europes-co-management-of-the-youth-sector/

Albanian Law

Law No. 69/2012, *On Pre-University Education* (2012).

Law No. 80/2015, *On Higher Education* (2015).

Law No. 139/2015, *On Local Self-Governance* (2015).

Law No. 75/2019, *On Youth* (2019).

Law No. 24/2025, *On Some Additions and Amendments to Law No. 75/2019, "On Youth"* (2025).

ANEKSET

Aneksi 1

Modeli i Projektit

1. **Titulli (Mbajeni titullin të shkurtër dhe bëjeni të qartë se cilat janë aktivitetet e propozuara. Përdorni jo më shumë se një fjali.)**
2. **Konteksti (Shpjegoni shkurtimisht problemin që do të trajtojë nisma dhe pse nevojitet veprimi. Përdorni jo më shumë se një paragraf.)**
3. **Objektivi (Përcaktoni qartë dhe shkurtimisht se çfarë duhet të arrijë ndërhyrja. Përfshini jo më shumë se dy objektiva.)**
4. **Aktivitetet (Përshkruani hapat kryesorë të nevojshëm për arritjen e objektivave. Mbajini të qartë dhe konkretë.)**
5. **Kostoja e parashikuar (Listoni kostot e pritshme, si ambienti, transporti, akomodimi, lehtësimi ose kontributet teknike. Puna e kontribuar në projekt konsiderohet vullnetare.)**
6. **Afati kohor** *(Përcaktoni datën e fillimit, piketat kryesore dhe datën e përfundimit.)*
7. **Rolet dhe përgjegjësitë** *(Përcaktoni kush është përgjegjës për çdo aktivitet, kush ka autoritetin përfundimtar të vendimmarrjes dhe kush miraton komunikimin.)*
8. **Emrat e partnerëve** *(Kush është i përfshirë?)*
9. **Vendndodhjet** *(Ku zhvillohen aktivitetet e propozuara?)*
10. **Komunikimi dhe pëlqimi** *(Përshkruani si do të komunikohet nisma dhe si do të merret pëlqimi, veçanërisht për të miturit.)*

Aneksi 2

Hartëzimi Praktik i Aktorëve

Pasi identifikojnë aktorët, KVR-ja mund të krijojë një hartë të thjeshtë që tregon kush janë ata, cilët të rinj arrijnë, çfarë bëjnë, çfarë mund të kontribuojnë dhe si mund të funksionojë bashkëpunimi.

Më pas KVR-ja duhet të identifikojë:

- **partnerët ekzistues** me të cilët punon tashmë;
- **partnerët e mundshëm** që mund t'i përfshijë në nisma të ardhshme; dhe
- **zërat që mungojnë**: të rinjtë ose grupet që nuk përfaqësohen ose nuk arrihen mjaftueshëm.

Shembulli më poshtë e zbaton mjetin e hartëzimit për aktorët e përshkruar në Kapitullin 4. Ai përdor një rrjetë të thjeshtë fuqie–interesi: fuqia (E lartë ose E ulët) është aftësia e aktorit për të ndikuar në bashkëpunimin e KVR-së, për shembull përmes vendimeve, financimit ose miratimit ligjor, ndërsa interesi (I lartë ose I ulët) është sa përputhen përparësitë e vetë aktorit me bashkëpunimin e KVR-së. Rrjeta sugjeron si duhet të angazhohet secili aktor (shihni përkufizimet nën tabelë). Shembulli paraqitet në format horizontal për lexim më të lehtë. Vlerësimet janë vetëm ilustruese; çdo KVR duhet të bëjë vlerësimin e vet për bashkinë e saj.

Aktori	Lidhja me bashkëpunimin e KVR-së	Fuqia	Interesi	Qasja e angazhimit	Angazhohet zakonisht përmes	Roli në nismë	Përgjegjësi	Data
Institucionet Kombëtare të Rinisë								
Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)	Bashkëfinancon veprimtaritë e KVR-së së bashku me bashkinë dhe mbështet standardet kombëtare për politikat rinore vendore.	E lartë	E lartë	Menaxhim i ngushtë	AKR / Bashkia			
Këshilli Kombëtar Rinor (KKR)	Homologu kombëtar me të cilin KVR-të janë të detyruara me ligj të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion; lidh përparësitë vendore me diskutimet kombëtare të politikave.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	Sekretariati i KVR-së			
Ministria përgjegjëse për Rininë	Përcakton drejtimin kombëtar të politikave rinore dhe mbikëqyr Strategjinë Kombëtare të Rinisë, me të cilën përputhet ky Udhëzues.	E lartë	E lartë	Menaxhim i ngushtë	AKR / Bashkia			
Qeverisja Bashkiake / Vendore								
Kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak	Kryetari bashkëkryeson KVR-në; këshilli duhet të miratojë zyrtarisht planet, strategjitë vendore për rininë dhe rregullat e funksionimit të KVR-së që ato të kenë fuqi ligjore.	E lartë	E lartë	Menaxhim i ngushtë	KVR (bashkëkryetari)			
Pika e kontaktit e bashkisë për rininë	Koordinon punën për rininë brenda administratës bashkiake, shpesh së bashku me detyra të tjera.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	Sekretariati i KVR-së			
Qendra rinore bashkiake ose e përbashkët	Ofron hapësirë fizike, infrastrukturë dhe mbështetje për arsimin joformal në aktivitetet rinore.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	KVR / Bashkia			
Organizatat Rinore dhe Grupet Joformale								
Organizatat rinore të regjistruara	OShC të udhëhequra nga të rinjtë, të njohura sipas Ligjit "Për Rininë"; ofrojnë programe dhe përfaqësojnë interesat e të rinjve.	E lartë	E lartë	Menaxhim i ngushtë	KVR			
Organizatat për të rinjtë	Organizata jofitimprurëse, puna kryesore e të cilave është diku tjetër, por që zhvillojnë programe për të rinjtë.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	KVR			
Grupet rinore joformale	Grupe të paregjistruara, të organizuara rreth një çështjeje, interesi ose fushate vendore.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	KVR			
Organizatat rome dhe egjiptiane të të rinjve	Organizata dhe grupe të udhëhequra nga të rinj romë e egjiptianë ose që punojnë me ta; e ndihmojnë KVR-në të arrijë të rinj që mund të hasin pengesa të veçanta për të marrë pjesë.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	KVR / Bashkia			
Organizatat e personave me aftësi të kufizuara	Përfaqësojnë të rinjtë me aftësi të kufizuara ose punojnë me ta; këshillojnë për aksesueshmërinë dhe përfshirjen në nismat e përbashkëta.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	KVR / Bashkia			
Aktorët e Sektorit të Arsimit								
Këshillat studentorë (niveli universitar)	Organe të zgjedhura studentore që ofrojnë qasje në këndvështrimet e studentëve për arsimin, punësimin dhe shërbimet vendore.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	KVR			
Këshillat e nxënësve (niveli i mesëm)	Struktura përfaqësuese të nxënësve – një nga kanalet e pakta të drejtpërdrejta drejt të rinjve në moshën e arsimit të mesëm.	E ulët	E ulët	Monitorim	KVR			
Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë	Platformë kombëtare për përfaqësimin e nxënësve; lidh pjesëmarrjen vendore në shkolla me rrjete më të gjera.	E ulët	E ulët	Monitorim	KVR / AKR			
Ekosistemi më i Gjerë Rinor								
Rrjetet rinore (rajonale/kombëtare/tematike)	Lidhin organizata dhe të rinj rreth një interesi të përbashkët; mbështesin shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin përtej bashkisë.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	KVR			

Aktori	Lidhja me bashkëpunimin e KVR-së	Fuqia	Interesi	Qasja e angazhimit	Angazhohet zakonisht përmes	Roli në nismë	Përgjegjësi	Data
Shkollat Qendër Komunitare	Lidhin shkollën me familjet dhe komunitetin më të gjerë; hapësira të dobishme për kontaktim e angazhim.	E ulët	E ulët	Monitorim	KVR			
Bibliotekat dhe hapësirat kulturore	Biblioteka publike, qendra kulturore dhe muze që ofrojnë hapësira të aksesueshme për aktivitete të udhëhequra nga të rinjtë.	E ulët	E ulët	Monitorim	KVR			
Punësimi, Shërbimet Sociale dhe Sektori Privat								
Zyra rajonale/vendore e punësimit (AKPA)	Me rëndësi kur KVR-ja punon për punësimin e të rinjve, NEET, orientimin në karrierë ose kalimin nga arsimi në punë.	E lartë	E ulët	Mbajtje e kënaqur	KVR / Bashkia			
Bizneset dhe shoqatat e punëdhënësve	Mund të ofrojnë praktika, mentorim, sponsorizim ose mbështetje në natyrë, veçanërisht për nismat që lidhen me punësimin dhe aftësitë.	E ulët	E ulët	Monitorim	KVR / Bashkia			
Aktorët Ndërkombëtarë, Rajonalë dhe Donatorë								
Përfaqësuesi Rinor i RYCO-s	Përfaqëson të rinjtë shqiptarë në Bordin Drejtues të RYCO-s, së bashku me ministrat e Ballkanit Perëndimor përgjegjës për rininë.	E ulët	E lartë	Mbajtje e informuar	AKR			
Ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare (struktura rinore)	Këshilla rinorë, borde këshillimore dhe rrjete ambasadorësh që ofrojnë shkëmbim, trajnim dhe bashkëpunim në projekte.	E ulët	E ulët	Monitorim	KVR / Bashkia			
Programet rinore të financuara nga BE-ja dhe donatorët	Partnerë ndërkombëtarë të zhvillimit dhe donatorë që financojnë pjesëmarrjen rinore dhe nisma të shoqërisë civile në nivel vendor.	E lartë	E lartë	Menaxhim i ngushtë	Bashkia / KVR			

Përkufizime: Fuqia = aftësia e aktorit për të ndikuar në bashkëpunimin e KVR-së, për shembull përmes vendimeve, financimit ose miratimit (E lartë/E ulët). Interesi = sa përputhen përparësitë e vetë aktorit me bashkëpunimin e KVR-së (I lartë/I ulët). Qasja e angazhimit ndjek rrjetën: fuqi e lartë dhe interes i lartë – menaxhim i ngushtë; fuqi e lartë dhe interes i ulët – mbajtje e kënaqur; fuqi e ulët dhe interes i lartë – mbajtje e informuar; fuqi e ulët dhe interes i ulët – monitorim. Vlerësimet janë ilustruese. Çdo KVR duhet të vlerësojë aktorët e vet dhe mund të shtojë një kolonë për shqetësime, mosmarrëveshje ose kundërshtime të mundshme, të cilat shpesh i anashkalon një vlerësim i parë.

Aneksi 3

Modelet e Vlerësimit

Modeli 1: Formulari i Kënaqësisë së Pjesëmarrësve

Mosha (opsionale): _____ **Gjinia (opsionale):** _____ ☐ Preferoj të mos them

Përdoreni këtë formular pas një trajnimi ose aktiviteti tjetër dhe përshtatni pyetjet me aktivitetin. Formulari është anonim dhe pjesëmarrësit nuk duhet t'u përgjigjen të gjitha pyetjeve. Ju lutemi vlerësoni çdo pohim nga 1 në 5, duke shënuar (✓) kutinë e duhur.

1 = Vlerësim minimal 2 = I ulët 3 = I kënaqshëm 4 = I mirë 5 = Vlerësim maksimal

Nr.	Pyetja e vlerësimit	1	2	3	4	5
1	Si e vlerësoni strukturën dhe axhendën e trajnimit?	☐	☐	☐	☐	☐
2	Sa i rëndësishëm dhe interesant ishte informacioni i ofruar?	☐	☐	☐	☐	☐
3	Si e vlerësoni aftësinë e trajnerit për t'i shpjeguar qartë temat?	☐	☐	☐	☐	☐
4	Si e vlerësoni metodologjinë e përdorur?	☐	☐	☐	☐	☐
5	Si e vlerësoni ekuilibrin ndërmjet teorisë dhe praktikës?	☐	☐	☐	☐	☐
6	Sa të dobishme ishin aktivitetet në grup?	☐	☐	☐	☐	☐
7	Sa i dobishëm pritet të jetë ky trajnim për të rinjtë?	☐	☐	☐	☐	☐
8	Si e vlerësoni nivelin e pjesëmarrjes dhe të bashkëpunimit?	☐	☐	☐	☐	☐
9	Si e vlerësoni organizimin e trajnimit?	☐	☐	☐	☐	☐
10	Në përgjithësi, sa i dobishëm ishte ky trajnim për ju?	☐	☐	☐	☐	☐

Komente / Sugjerime

Qëllimi i formularit: të mblidhen reagime dhe sugjerime që mund të përmirësojnë aktivitetet e ardhshme të trajnimit.

Modeli 2: Formulari i Vlerësimit të Aktivitetit

Nisma: _____ Data: _____ Partnerët: _____

Duhet të plotësohet së bashku nga KVR-ja dhe partnerët e saj pas aktivitetit, duke përdorur objektivin dhe rezultatet e pritshme të shkruara në planin e Aneksit 1. Ju lutemi vlerësoni çdo pohim nga 1 në 5, duke shënuar (✓) kutinë e duhur.

1 = Vlerësim minimal 2 = I ulët 3 = I kënaqshëm 4 = I mirë 5 = Vlerësim maksimal

Nr.	Pyetja e vlerësimit	1	2	3	4	5
1	Objektivi i nismës ishte i përcaktuar qartë dhe i ndarë nga të gjithë partnerët.	☐	☐	☐	☐	☐
2	Rezultatet e pritshme u arritën.	☐	☐	☐	☐	☐
3	Nisma u realizua brenda afatit kohor të dakordësuar.	☐	☐	☐	☐	☐
4	Nisma u realizua brenda buxhetit dhe burimeve të dakordësuara.	☐	☐	☐	☐	☐
5	Rolet dhe përgjegjësitë ishin të qarta dhe u respektuan nga të gjithë partnerët.	☐	☐	☐	☐	☐
6	Komunikimi ndërmjet partnerëve funksionoi mirë.	☐	☐	☐	☐	☐
7	Nisma arriti të rinjtë e synuar, përfshirë ata nga grupet e nënpërfaqësuara.	☐	☐	☐	☐	☐
8	Të rinjtë morën pjesë në planifikim dhe në vendime, dhe jo vetëm në aktivitete.	☐	☐	☐	☐	☐
9	U respektuan masat e pëlqimit dhe të mbrojtjes, përfshirë për të miturit.	☐	☐	☐	☐	☐
10	Pjesëmarrësve iu tha se si u përdorën reagimet e tyre.	☐	☐	☐	☐	☐

Pyetje të hapura

Çfarë funksionoi mirë? _____

Çfarë nuk funksionoi dhe pse? _____

Çfarë duhet bërë ndryshe herën tjetër? _____

A duhet të vazhdojë, të ndryshojë apo të përfundojë bashkëpunimi? (përsëritje / zgjerim / formalizim / mbyllje) _____

Qëllimi i formularit: të ndihmojë KVR-në dhe partnerët e saj të vlerësojnë rezultatet e një nisme të përbashkët dhe të vendosin çfarë të përsërisin, ndryshojnë ose përfundojnë.

Aneksi 4

MODELI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

Udhëzim për përdoruesit: *KVR-ja është organ këshillimor i bashkisë dhe nuk ka personalitet juridik të vetin. Për një MM që përfshin KVR-në, e nënshkruan bashkia (përmes kryetarit të bashkisë si bashkëkryetar i KVR-së) ose vendos këshilli bashkiak; partneri nënshkruan në emër të vet. Zëvendësoni tekstin në kllapa katrore dhe fshini atë që nuk zbatohet.*

MEMORANDUM BASHKËPUMI

NDËRMJET

[BASHKIA] (që vepron në emër të Këshillit të saj Vendor Rinor)

DHE

[EMRI I PARTNERIT]

I. HYRJE

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM), me datë __/__/__, është lidhur ndërmjet [BASHKIA] ("Bashkia"), me zyra në _____, e përfaqësuar nga _____, Kryetar i Bashkisë dhe bashkëkryetar i Këshillit Vendor Rinor të [BASHKIA] ("KVR-ja"), që vepron [mbi bazën e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. ___ datë __/__/__];

dhe

[EMRI I PARTNERIT] ("PARTNERI"), një [organizatë rinore / organizatë për të rinjtë / këshill studentor / qendër rinore / grup rinor joformal i përfaqësuar nga koordinatori i tij] me zyra në _____, e përfaqësuar nga _____; së bashku të quajtura "Palët".

II. PARATHËNIE

DUKE PARË që objektivi i këtij MM është të mbështesë bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen ndërmjet Bashkisë, që vepron përmes Këshillit të saj Vendor Rinor, dhe Partnerit në _____;

DUKE PARË që KVR-ja është organ këshillimor i Bashkisë pa personalitet juridik të vetin, dhe se Bashkia e nënshkruan këtë MM në emër të saj;

DUKE PARË që misionet e Palëve janë plotësuese;

PËR KËTË ARSYE, Palët dëshirojnë të punojnë së bashku sipas klauzolave të mëposhtme:

III. QËLLIMI

Ky MM formalizon një partneritet ndërmjet Bashkisë (që vepron përmes KVR-së së saj) dhe Partnerit me qëllim _____.

Ai përcakton kushtet e partneritetit si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë në kryerjen e aktiviteteve të dakordësuara.

IV. FUSHAT E BASHKËPUNIMIT DHE PËRGJEGJËSITË E DAKORDËSUARA TË PALËVE

V. KONTAKTET KRYESORE

Kontaktet kryesore për organizatat janë:

[BASHKIA / KVR]:
[EMRI I KONTAKTIT KRYESOR]:
[TITULLI]:
[ADRESA]:
[TELEFONI]:

[PARTNERI]:

[EMRI I KONTAKTIT KRYESOR]:
[TITULLI]:
[ADRESA]:
[TELEFONI]:

Palët përkatëse mund t'i ndryshojnë kontaktet kryesore me njoftim me shkrim.

VI. PËRDORIMI I PRONËSISË INTELEKTUALE

Palët bien dakord që çdo pronësi intelektuale e zhvilluar së bashku përmes aktiviteteve që mbulohen nga ky MM mund të përdoret nga secila palë për qëllime jofitimprurëse dhe jokomerciale, pa pëlqim të mëtejshëm ose llogaridhënie ndaj palës tjetër.

I gjithë pronësia tjetër intelektuale e përdorur në zbatimin e këtij MM mbetet pronë e palës që e ka dhënë. Secila palë mund ta përdorë atë pronësi për qëllimet që mbulohen nga marrëveshja. Për përdorimin e saj jashtë marrëveshjes kërkohet pëlqimi i pronarit.

VII. DATAT E HYRJES NË FUQI DHE NDRYSHIMET

Ky MM hyn në fuqi kur nënshkruhet nga të dyja Palët dhe mbetet në fuqi deri më __/__/____ (ose për ____ muaj nga ajo datë), përveç nëse përfundon më herët. Asnjëra Palë nuk mund ta transferojë ose ta kalojë tërësisht ose pjesërisht këtë MM pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.

MM mund të rinovohet me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim. Dispozitat e tij mund të ndryshohen ose të hiqen vetëm me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim të të dyja Palëve.

Secila Palë mund ta përfundojë këtë MM, si dhe çdo plan pune e buxhet të lidhur me të, në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, duke i dhënë Palës tjetër njoftim paraprak me shkrim (X) ditë përpara. Një Palë mund ta përfundojë menjëherë këtë MM me njoftim me shkrim nëse pala

tjetër nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e saj sipas këtij MM dhe nuk e korrigjon mospërmbushjen brenda (X) ditëve nga njoftimi për të.

Personat që nënshkruajnë këtë MM në emër të subjekteve të tyre konfirmojnë se kanë autorizim për ta bërë këtë.

VIII. MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE MBROJTJA E TË MITURVE

Palët do t'i përpunojnë të dhënat personale vetëm për qëllimet e këtij MM dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Palët do të marrin pëlqimin e prindërve ose të kujdestarëve, kur kërkohet, për pjesëmarrësit që janë të mitur (nën 18 vjeç) dhe do të sigurojnë që aktivitetet e kryera sipas këtij MM të jenë të sigurta dhe të përshtatshme për moshën e pjesëmarrësve. Fotografitë, incizimet video dhe historitë personale të pjesëmarrësve do të përdoren dhe publikohen vetëm me pëlqimin e tyre (dhe, për të miturit, me pëlqimin e një prindi ose kujdestari), dhe pëlqimi mund të tërhiqet. Secila Palë do të caktojë një person përgjegjës për shqetësimet e mbrojtjes: [EMRI DHE KONTAKTI].

IX. KOMUNIKIMI DHE DUKSHMËRIA

Palët do të dakordësohen paraprakisht se kush përgatit, miraton dhe publikon komunikimin për aktivitetet e përbashkëta dhe cilat kanale do të përdoren. Emrat dhe logot e Palëve, si dhe të çdo financuesi, do të shfaqen në mënyrë të drejtë dhe të njëtrajtshme, dhe asnjë Palë nuk do ta përdorë emrin ose logon e një Pale tjetër pa pëlqimin e saj. Kërkesat e financuesit për dukshmërinë, kur zbatohen, do të ndiqen.

X. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet Palëve lidhur me këtë MM, ato fillimisht do të përpiqen ta zgjidhin përmes diskutimit joformal. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet joformalisht brenda (X) ditëve kalendarike radhazi, Palët do të përpiqen ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit, me kusht që të bien dakord për një ndërmjetës.

PLOTËSIA

Ky MM, përfshirë të gjitha Aneksat, përfaqëson mirëkuptimin e plotë ndërmjet Palëve. Çdo ndryshim duhet të nënshkruhet nga të dyja Palët.

PËR BASHKINË PËR PARTNERIN

_____ _____

Data: __/__/20__ Data: __/__/20__

Aneksi 5

RASTE STUDIMORE NGA PRAKTIKA

Ky Aneks paraqet tre shembuj bashkëpunimi nga të cilët KVR-të mund të nxjerrin mësime: dy nga Shqipëria dhe një krahasues evropian.

Rasti Studimor 1 – Kavajë, Shqipëri

Bashkia Kavajë zhvillon një thirrje publike të përhershme, duke ftuar organizatat e shoqërisë civile dhe të rinjtë të paraqesin propozime projektesh për aktivitetet e KVR-së. Në vend të një ftese të njëhershme, kjo krijon një mekanizëm të përsëritur financimi bashkiak, përmes të cilit të rinjtë dhe OShC-të vendore mund të formësojnë dhe të realizojnë nismat e tyre.

Bashkia siguron linjën e financimit, procesin e thirrjes publike dhe mbështetjen formale përmes KVR-së. OShC-të dhe grupet rinore aplikuese kontribuojnë me ide, kapacitet realizimi dhe kontakt të drejtpërdrejtë me të rinj që KVR-ja mund të mos i arrijë vetë.

Skema ka financuar një sërë projektesh të udhëhequra nga të rinjtë përmes thirrjeve të përsëritura.

Mësimi për KVR-të e tjera është se bashkëpunimi bëhet më i qëndrueshëm kur integrohet në një proces bashkiak të përsëritur, në vend që të varet nga dikush që ta organizojë atë çdo vit. Një thirrje e përhershme është një shembull praktik i modelit të Mekanizmave Formalë në Seksionin 5.1.1.

Rasti Studimor 2 – Shkodër, Shqipëri

Në Shkodër, përfaqësues të KVR-së dhe YËCA, si partner zbatues që punon për çështjet rinore, marrin pjesë së bashku në një Rrjet Vendor Partneriteti me bazë në qendrën rinore Atelie. Prioriteti i tyre i përbashkët është të arrijnë të rinjtë që nuk janë në arsim, punësim apo trajnim (NEET) me informacion dhe mbështetje në kuadër të skemës së Garancisë Rinore. Ky është një grup që mund të jetë i vështirë për t'u arritur nga secili partner më vete.

KVR-ja sjell pozicionin e saj institucional dhe lidhjen e drejtpërdrejtë me bashkinë. YËCA sjell përvojë në kontaktimin e të rinjve dhe marrëdhënie të vendosura me të rinj NEET përmes programeve të saj.

Mësimi është se një KVR nuk ka nevojë ta kryejë e vetme kontaktimin dhe angazhimin me grupet që janë të vështira për t'u arritur. Bashkëpunimi me një aktor që tashmë ka akses dhe besim mund të jetë më efektiv sesa ndërtimi nga e para i të njëjtave marrëdhënie. Kjo ilustron parimin e Pronësisë dhe Përgjegjësisë së Përbashkët në Seksionin 3.

Rasti Studimor 3 – Sistemi i Bashkëmenaxhimit i Këshillit të Evropës

Këshilli i Evropës e ka zbatuar një sistem bashkëmenaxhimi në sektorin e tij rinor që nga viti 1972. Ai bashkon Këshillin Këshillimor për Rininë, të përbërë nga 30 përfaqësues të organizatave dhe rrjeteve rinore joqeveritare, dhe Komitetin Evropian Drejtues për Rininë, të përbërë nga përfaqësues të qeverive të shteteve palë në Konventën Kulturore Evropiane. Së bashku ata formojnë Këshillin e Përbashkët për Rininë. Sistemi synon të sigurojë që politika

evropiane për rininë të pasqyrojë përvojën e të rinjve përmes vendimmarrjes së përbashkët dhe jo vetëm përmes konsultimit (Council of Europe, n.d.).

Tipari i tij përcaktues është se organizatat rinore dhe qeveritë kanë zë të barabartë në vendime dhe në hartimin e politikave. Kur sistemi mori Çmimin Bronz të Politikave të së Ardhmes 2019, të dhënë nga Këshilli Botëror i të Ardhmes me Unionin Ndërparlamentar dhe Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, ai kishte dhënë më shumë se 10 000 grante për organizata rinore në të gjithë Evropën, me vlerë të përgjithshme mbi 130 milionë euro, dhe më shumë se 70 000 udhëheqës e aktivistë rinorë kishin marrë pjesë në sesione studimi në Qendrat Evropiane të Rinisë të Këshillit (Ëorld Future Council, 2019).

Një KVR shqiptare nuk mund ta riprodhojë këtë model në të njëjtën shkallë, por parimi themelor mbetet i zbatueshëm: bashkëpunimi është më i fortë kur partnerët ndihmojnë në formësimin e vendimeve, në vend që thjesht t'i vëzhgojnë ato. Kjo pasqyron parimin e Pronësisë dhe Përgjegjësisë së Përbashkët në Seksionin 3 dhe mund të mbështetet përmes mjeteve të tilla si një Memorandum Mirëkuptimi ose një grup i përhershëm i përbashkët pune (Seksioni 5.1.1).